BULETIN INFORMATIV

TETOR 2025

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË

Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Tetor, 2025

Përmbajtje

Aktivitete ndërkombëtare, ballkanike dhe mbarëkombëtare 7

Çel punimet Konferenca e Dytë Ndërkombëtare me temën "Ndryshimet demografike dhe dinamika e tregut të punës – sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri, Kosovë dhe rajon" 8

Mbyll punimet Konferenca Ndërkombëtare: Ndryshimet demografike dhe dinamika e tregut të punës – sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri, Kosovë dhe Rajon 16

U zhvillua konferenca e dytë ndërkombëtare me temën: "Çështjet e strehimit, planifikimit, zhvillimit rezilient urban dhe territorit: drejt një qasjeje euro-mesdhetare" 24

U mbajt Konferenca e 11-të Ballkanike e Informatikës (BCI 2025)..... 28

Për herë të parë në Shqipëri u mbajt takimi vjetor i Grupit Europian të Këshillit Ndërkombëtar të Shkencës (ISC) 31

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetari i Akademisë së Shkencave, përshëndeti konferencën shkencore mbarëkombëtare: "Muzika shqiptare si krijimtari, interpretim, muzikologji dhe edukim artistik" 36

Mbylli me sukses punimet konferenca shkencore mbarëkombëtare "Muzika shqiptare si krijimtari, interpretim, muzikologji dhe edukim artistik" 39

Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH 47

U mbajt mbledhja e Komisionit të mjekësisë 48

U mbajt mbledhja e Komisionit të Matematikë-Informatikës 49

U mbajt mbledhja e Komisionit të fizikë-kimisë..... 50

Aktivitete të tjera..... 51

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u uron përzemërsisht një vit akademik sa më të mbarë e të suksesshëm studentëve dhe pedagogëve..... 52

Filloi punimet dyditore konferenca e 3-të Kombëtare e Matematikës NMC-2025 53

U mbajt forumi me temën "Prodhimi i perimeve në serrë, metodë shumë intensive dhe sfidat aktuale" 57

Zhvillohet tryeza shkencore mbi parimin themelor të drejtshkrimit të gjuhës shqipe 61

U promovua monografia shkencore "Edi Rama – Neuroestetika e një artisti" e autorit Oltsen Gripshi 63

U mbajt ceremonia e kremtimit të 30-vjetorit të revistës "Studime për artin" 68

U mbajt tryeza e rrumbullakët me temën "Vendi i gjeografisë teknike në shkencën gjeografike" 70

Takimi me korrektorët e Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe 73

U promovua numri i veçantë i revistës shkencore ndërkombëtare "Polis" kushtuar Shqipërisë dhe shqiptarëve 74

Pjesëmarrje të studiuesve të ASHSH në aktivitete 76

U mbajt në Prishtinë konferenca dyditore ndërkombëtare "Studimet albanistike te sllavët e jugut" 77

U mbajt konferenca shkencore me temën "Kriza lindore 1875-1878 dhe shqiptarët" . 80

U mbajt konferencë shkencore me rastin e 100-vjetorin të rënies së Heroit të Popullit Bajram Curri 82

Biblioteka e Akademisë së Shkencave në 90-vjetorin e Bibliotekës Publike "Mitrush Kuteli", Pogradec 84

Konsorciumi i Bibliotekave të Shqipërisë në Asamblenë e Përgjithshme të EIFL (Electronic Information for Libraries) 2025 86

U mbajtën punimet e konferencës shkencore ndërkombëtare me tematikë "Studimet albanistike te sllavët e jugut" 88

Prof. as. dr. Rovena Vata Mikeli mori pjesë në Konferencën shkencore "Personalitete dhe figura me vlera shkencore dhe kulturore shqiptare nga Lugina e Preshevës dhe viseve të tjera shqiptare 90

Prof. as. dr. Evalda Paci mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare me tematikë qendrore "Qasje ndërdisiplinore, sinergji dhe risi në shkencat humane dhe shoqërore" 92

Prof. as. dr. Rovena Vata Mikeli ishte e ftuar në aktivitetin përkujtimor kushtuar 125 vjetorit të ndarjes nga jeta të poetit të madh të rilindjes, Naim Frashërit 94

Dr. Valbona Sinanaj ka kryer një praktikë të shkurtër kërkimore - shkencore, pranë Universitetit të Kalabrisë (UNICAL) 96

Pof. as. dr. Rovena Vata Mikeli mori pjesë në aktivitetin përkujtimor kushtuar jetës dhe veprës së shkrimtarit Dritëro Agolli, me rastin e ditës së tij të lindjes: "Dritëro Agolli dhe universaliteti në veprën e tij" 98

Vizitë pune 100

Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi pret në një vizitë zyrtare drejtorin e Institutit për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, dr. Besnik Eminin 101

Të reja nga bota akademike 103

U mbajt konferenca e 9-të e përbashkët shkencore në kuadër të Procesit të Berlinit 2025, Shkenca nën presion: sfidat dhe mundësitë; Lubjanë, Slloveni 104

Akad. Anila Hoda mori pjesë në Asamblenë e 93-të të Union Académique Internationale (UAI), zhvilluar në Mainz të Gjermanisë 106

Akademia e Shkencave e Shqipërisë pranohet anëtare nderi e Komunitetit Ndërkombëtar të Akademive – Koinon 108

Akad. Arben Merkoçi zgjidhet anëtar i Komitetit të Përhershëm për Politikat Shkencore të ALLEA-s (All European Academies) 109

Akademik Nazim Gruda vlerësohet me diplomën "Shkencëtar i shquar" nga Akademia Kineze e Shkencave 110

Çmimet Nobel 112

Joel Mokyr, Philippe Aghion dhe Peter Hoëitt vlerësohen me çmimin "Nobel" 2025 në ekonomi 113

Maria Corina Machado fiton çmimin Nobel për Paqen 2025 114

Çmimi "Nobel" 2025 në letërsi iu dha shkrimtarit hungarez László Krasznahorkai 115

Jepet çmimi "Nobel" 2025 në fizikë për tre shkencëtarët: John Clarke, Michel H. Devoret dhe John M. Martinis 116

Jepet çmimi "Nobel" 2025 në fiziologji ose mjekësi për tre shkencëtarë: Mary E. Brunkoë, Fred Ramsdell dhe Shimon Sakaguchi 117

Shpallet çmimi Nobel 2024 në kimi për tre shkencëtarë: gjysma iu dha David Baker-it dhe gjysma tjetër iu dha shkencëtarëve Demis Hassabis dhe John M. Jumper 118

In memoriam **119**

Akademia e Shkencave kujton me nderim shkrimtarin akademik Dritëro Agolli në 94-vjetorin e lindjes 120

Mesazh ngushëllimi 121

Aktivitete ndërkombëtare, ballkanike dhe mbarëkombëtare

Çel punimet Konferenca e Dytë Ndërkombëtare me temën "Ndryshimet demografike dhe dinamika e tregut të punës – sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri, Kosovë dhe rajon"

Kjo veprimtari shkencore organizohet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, duke mundësuar kështu organizimin e dytë të saj në Tiranë pas konferencës së parë të vitit 2023 në Kosovë.

Në ceremoninë e hapjes nderuan me praninë e tyre: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z Bajram Begaj; Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akad. Mehmet Kraja; zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil S. Tole; Ministrja e Ekonomisë dhe e Inovacionit, znj. Delina Ibrahimaj; Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko; Përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Shqipëri, znj. Randi Davis; anëtarë të Kryesisë së ASHSH-së dhe ASHAK-ut, rektorë universitetesh, akademikë, profesorë, shkencëtarë e studiues të fushës nga vendi, rajoni dhe më gjerë.

Seanca plenare nisi me fjalën e hapjes të akad. Anastas Angjelit, kryetar i Komisionit të Ekonomisë, Shkencave Sociale dhe Juridike (ASHSH). Në emër të komisionit organizator, ai u shpreh se tematika e konferencës lidhet me problematikat vendimtare për të ardhmen e shoqërive tona, që nuk prek thjesht çështjet ekonomike apo statistikore, por edhe dimensionin njerëzor të zhvillimit. "Gjatë dekadës së fundit, Shqipëria, Kosova dhe shumë vende të rajonit kanë përjetuar ndryshime të thella demografike të cilat nuk vijnë vetëm nga largimi në vendet, rënien e lindshmërisë,

emigracionin e vazhdueshëm të të rinjve, plakjen graduale të popullsisë dhe ristrukturimin e tregut të punës. Këto janë procese komplekse, me shkaqe të ndërthurura – ekonomike, sociale, kulturore e politike – që kërkojnë analizë të thelluar, të dhëna të sakta dhe politika të menduara afatgjatë." -tha akad Angjeli.

Më tej, ai e vlerësoi konferencën si një hap të rëndësishëm në bashkëpunimin institucional dhe shkencor ndërmjet dy akademive si një partneritet që tashmë po shndërrohet në një platformë të përbashkët kërkimore shqiptare dhe rajonale, ku ide, përvoja dhe analiza shkencore ndërthuren për t'u vënë në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm, integrimit europian dhe përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve tanë.

Akad. Angjeli shprehu bindjen se kjo konferencë mund të hedhë themelet e dialogut shkencor, të nxisë bashkëpunim ndërinstitucional dhe të krijojë hapësira për politika të reja të bazuara në dije, me synimin për të kontribuar për ndërtimin e një strategjie kombëtare dhe rajonale të zhvillimit të qëndrueshëm.

Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akad. Mehmet Kraja vlerësoi punën e organizatorëve dhe pjesëmarrësve të konferencës, duke marrë në shqyrtim një problematikë, siç është demografia dhe tregu i punës, e cila ka filluar të bëhet një çështje e mprehtë për shumicën e shteteve të Europës, përfshirë edhe shtetet e rajonit të Ballkanit, perëndimor ose jo tamam perëndimor. "Nëse i kuptojmë drejt dhe i paraprijmë këtyre ndryshimeve me strategji afatgjata dhe politika të mirëmenduara e të koordinuara, ato të mund të kthehen nga sfida, në mundësi. Ne kemi nevojë për një treg më të bashkuar, më të koordinuar, që i gjithë rajoni të bëhet më tërheqës, tërheqës për investime dhe projekte të përbashkëta zhvillimi. Në këtë kontekst, procesi i integrimit evropian mbetet rruga më e qëndrueshme për zhvillim afatgjatë dhe zbut disa shkaqe të emigracionit."- tha akad. Kraja.

Ai solli në vëmendje arritjet e qeverive të Europës, të cilat tashmë kanë hartuar projekte për përmirësime demografike, për ndërprerjen e trendit negativ demografik dhe rikthimin e treguesve pozitivë, jo vetëm në raport me tregun e punës, por në raport edhe me treguesit e tjerë, që mund të definohen si faktor të sigurisë, të mirëmbajtjes materiale të shoqërive në këtë nivel të mirëqenies.

Akad. Kraja tha se "Sfidat demografike e të tregut të punës janë kombëtare e rajonale dhe përvoja e suksesshme e vendeve të tjera tregon se ato mund të përballohen më lehtë nëse ka bashkëpunim, nëse ka integrim dhe zhvillim ekonomik. Në këto kushte, bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Kosovës, integrimi rajonal dhe procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian marrin një kuptim të ri."

Në fund, ai vlerësoi si prioritet bashkëpunimin në të gjitha fushat mes Shqipërisë e Kosovës dhe shqiptarëve në rajon për krijuar më shumë mundësi, më shumë qëndrueshmëri dhe më shumë shpresë për të rinjtë tanë.

Në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Kryesisë së saj, konferencën e përshëndeti zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil S. Tole. Kjo konferencë shkencore, e cila i kushtohet një teme të ndjeshme e me rëndësi strategjike për të ardhmen e vendeve tona dhe të rajonit, ka bërë bashkë dy akademitë tona përmes një bashkëpunimi të ngushtë e të frytshëm, duke i afruar universitetet, studiuesit dhe ekspertët e fushës për të dhënë kontribute shkencore në një çështje kaq madhore. Në dekadat e fundit, realiteti demografik i Shqipërisë, Kosovës dhe rajonit tonë ka ndryshuar rrënjësisht. Popullsia është në tkurrje, ritmet e lindshmërisë janë ulur, emigracioni masiv i të rinjve ka sjellë boshatisjen e shumë zonave dhe humbjen e potencialeve të vlefshme njerëzore.

Akad. Tole e vlerësoi konferencën si një dëshmi të përkushtimit të përbashkët për të vendosur dijen dhe kërkimin shkencor në shërbim të shoqërisë. Përballë sfidave të sotme, akademitë nuk janë vetëm institucione të traditës, por edhe institucione të rëndësishme rekomanduese e këshilluese, që me rolin e tyre shërbejnë si ura mes shkencës dhe politikës, mes dijes dhe vendimmarrjes. Kjo është një praktikë që e gjejmë në të gjitha vendet europiane dhe që po bëhet gjithnjë e më shumë pjesë e vizionit tonë për akademinë si partner strategjik të shtetit dhe të shoqërisë. Ne jemi të vetëdijshëm se përmasat e sfidave demografike e ekonomike janë të tilla që nuk mund të adresohen vetëm nga një vend apo nga një institucion i vetëm. Ato kërkojnë një qasje të koordinuar, një dialog rajonal dhe një bashkëpunim të vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z Bajram Begaj, në fjalën e tij përgëzoi organizatorët për këtë nismë që bashkon mendimin shkencor dhe institucional për të analizuar një nga sfidat më të mëdha të zhvillimit tonë, demografinë, tregun e punës dhe ndikimin e tyre në ekonominë e vendeve tona. Tema e konferencës vështirë se do të ishte më e rëndësishme dhe më me vend po të kemi parasysh zhvillimet e tanishme dhe ato të pritshme demografike. Ato prekin themelet e shoqërisë sonë: sigurinë, familjen, punësimin, mirëqenien dhe perspektivën zhvillimore, prekin të ardhmen tonë. Parashikimet e Kombeve të Bashkuara mbi numrin e popullsisë në vendet e rajonit tonë janë mjaft pesimiste dhe realiteti i sotëm po i konfirmon. Sot, Shqipëria, Kosova dhe Ballkani Perëndimor po përballen me një tranzicion demografik. Popullsia po zvogëlohet dhe plaket për shkak të lindshmërisë së ulët, të emigracionit, si dhe po përqendrohet gjithnjë e më shumë në qytetet e mëdha si pasojë e migrimit të brendshëm.

Më tej, presidenti Begaj tha se zhvillimet negative demografike nënkuptojnë sfida serioze jo vetëm për ekonominë, por dhe më gjerë, për sigurinë tonë kombëtare. Ato sjellin uljen e bazës ekonomike dhe tatimore të shtetit, uljen e aftësisë prodhuese të fuqisë punëtore dhe mbingarkojnë sistemet e pensioneve dhe ato të shëndetësisë. Shpopullimi i zonave rurale dhe kufitare dëmton kohezionin social dhe kontrollin territorial, ndërsa emigracioni i të rinjve zvogëlon kapitalin njerëzor dhe kapacitetin mbrojtës të vendit. Uroj që kjo konferencë të arrijë suksese dhe të mund të ofrojë propozime konkrete që merren me shkaqet dhe jo me pasojat.

E ardhmja e Shqipërisë dhe e Kosovës do të varet nga aftësia jonë, nga aftësia jonë për ta fituar këtë betejë. Kjo është sfida e brezit të sotshëm dhe përballimi i saj me sukses është detyrimi ynë, detyrimi ynë për brezat e ardhshëm.

Ministrja e Ekonomisë dhe e Inovacionit, znj. Delina Ibrahimaj e vlerësoi konferencën si një ngjarje me rëndësi për shpresat dhe zgjedhjet e qytetarëve tanë dhe shoqërisë sonë për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve që po ndodhin, të cilat kërkojnë një qasje të re politike, që të lidh arsimin, trajnimin profesional, inovacionin dhe punësimin në një sistem të vetëm dinamik dhe elastik.

"Në këtë frymë, Shqipëria ka ndërmarrë hapa konkretë për të forcuar lidhjen midis arsimit dhe ekonomisë reale. Janë përditësuar kurrikulat profesionale, janë zhvilluar programe të reja për aftësi në energji të rinovueshme, siguri kibernetike, turizëm dhe teknologji informacioni, ndërsa bashkëpunimi me biznesin është bërë tashmë pjesë e qeverisjes së arsimit profesional. Ky bashkëpunim është thelbësor sepse asnjë sistem arsimor nuk mund të funksionojë i shkëputur nga ekonomia që kërkon t'i shërbejë. Puna dhe arsimi janë bërë pjesë e një cikli të pandarë që kërkon mësim të

vazhdueshëm, rikualifikim dhe përmirësim të aftësive. Në këtë drejtim, po promovojmë një kulturë të të nxënit gjatë gjithë jetës, me programe për aftësi digjitale, soft skills, si dhe përfshirjen e "mikro-kualifikimeve" që u japin njerëzve më shumë fleksibilitet për t'u zhvilluar profesionalisht. Në partneritet me sektorin privat, po zgjerojmë aksesin në trajnime praktike, ndërsa digjitalizimi po e bën procesin më gjithëpërfshirës. Platforma **puna.gov.al** po i lidh qytetarët me vendet e punës në kohë reale, ndërsa aplikacionet e reja me inteligjencë artificiale po ndihmojnë të rinjtë të orientojnë karrierën e tyre me më shumë vetëdije dhe efikasitet. E ardhmja jonë varet nga mënyra si do të investojmë sot në njerëz; në aftësi, dije dhe mundësi.-tha znj. Ibrahimaj.

Konferencën e përshëndeti edhe përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së në Shqipëri, znj. Randi Davis.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko u shpreh se ekonomia e Shqipërisë vijon të shënojë ecuri të mirë. Megjithatë, horizonti afatgjatë kërkon adresimin e disa sfidave strukturore si: rritja e produktivitetit, përshtatja me risitë teknologjike, përfshirë këtu dhe zhvillimin e madh të inteligjencës artificiale e digjitalizimit, si dhe kufizimet në burime, veçanërisht ato që lidhen me tregjet e punës. Në dritën e objektivit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030, integrimi evropian do të krijojë mundësi të reja për tregtinë, investimet dhe konvergjencën institucionale. Megjithatë, përvojat që tashmë kemi nga zgjerimet e mëparshme tregojnë se ky integrim mund të përshpejtojë lëvizshmërinë e fuqisë punëtore, veçanërisht të të rinjve dhe punonjësve të kualifikuar, drejt vendeve anëtare me ekonomi më të zhvilluara.

Guvernatori vlerësoi se në Shqipëri, si rezultat i kushteve të favorshme të kursit të këmbimit dhe qëndrimeve të duhura të politikës monetare, inflacioni qëndron pranë objektivit të bankës qendrore. Megjithatë, në harkun kohor afatmesëm apo afatgjatë, ndryshimet strukturore në tregun e punës mund të shkaktojnë presione inflacioniste. Deficiti strukturor i vazhdueshëm i fuqisë punëtore, i shoqëruar me plakjen e popullsisë, emigracionin dhe mospërputhjen e aftësive, mund të shkaktojë rritje të pakthyeshme të pagave, veçanërisht nëse nuk shoqërohet edhe me rritje të produktivitetit. Në afat të gjatë, këto dinamika demografike ushtrojnë presion, duke kufizuar kapacitetin e politikës monetare për të stimuluar aktivitetin ekonomik.

Konferenca u zhvillua në pesë panele tematike me ligjërues kryesorë, z. Volker Treichel, ekspert i lartë i zhvillimit ekonomik ndërkombëtar, dr. Zsolt Darvas, studiues në Institutin "Bruegel" në Bruksel, prof. Ëill Bartlett, njohës i shquar i zhvillimeve ekonomike dhe sociale të Ballkanit Perëndimor.

Punimet shkencore trajtuan çështjen e krizës demografike, potencialin e zhvillimit ekonomik në dekadat e ardhshme, integrimin në Bashkimin Europian dhe lëvizjen e lirë të njerëzve, dijes dhe kapitaleve; sfidat dhe mundësitë për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm. Gjithashtu u paraqitën kërkime ndërdisiplinore, që nga ekonomia e sociologjia, tek politikat e arsimit, teknologjisë dhe punësimit; dixhitalizimi, automatizimi dhe inteligjenca artificiale e më gjerë, në kuadrin e një një debati më të gjerë mbi vetë kuptimin e zhvillimit, në një kohë kur ekonomia globale përballet me pasiguri, me kriza energjetike, klimaterike e gjeopolitike, si një domosdoshmëri për të rishikuar mënyrën se si e matim dhe e kuptojmë progresin.

Pas sesionit të sotëm, punimet do të vazhdojnë në disa panele të tjera tematike gjatë dy ditëve të konferencës në mjediset e Akademisë së Shkencave.

68 kumtues: profesorë, studiues dhe ekspertë nga 10 universitete dhe institute kërkimore të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi , do të paraqesin rezultatet e kërkimeve të tyre shkencore dhe propozime për politika të reja zhvillimore.

www.akad.gov.al

Mbyll punimet Konferenca Ndërkombëtare: Ndryshimet demografike dhe dinamika e tregut të punës – sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri, Kosovë dhe Rajon

Konkluzionet kryesore

1. Ndryshimet demografike dhe sfidat e reja të zhvillimit

Konferenca nxori në pah se ndryshimet demografike në Shqipëri, Kosovë dhe rajonin më të gjerë të Ballkanit Perëndimor kanë hyrë në një fazë kritike, me pasoja të ndjeshme mbi zhvillimin ekonomik, social dhe institucional.

Në dekadën e fundit, emigracioni masiv, plakja e popullsisë dhe tkurrja e bazës së fuqisë punëtore aktive janë shndërruar në faktorë që kërcënojnë strukturën e qëndrueshmërisë ekonomike dhe perspektivën e rritjes afatgjatë.

Në Shqipëri, të dhënat e reja demografike dëshmojnë për një shkallë të lartë të emigracionit të të rinjve me arsim të lartë, ndërsa në Kosovë, pavarësisht një norme më të lartë lindshmërie, intensiteti i emigrimit ekonomik dhe arsimor ka prodhuar një boshllëk të ndjeshëm në tregun e punës dhe në sektorët publikë.

Një konstatim i përbashkët i studiuesve ishte se tranzicioni demografik nuk është më një dukuri pasive që mund të përballohet me masa të pjesshme, por një sfidë sistemike që kërkon koordinim ndërsektorial: demografi, arsim, punësim, mirëqenie dhe teknologji.

Ky tranzicion po shoqërohet gjithashtu me depopullim rural, humbje të territoreve bujqësore dhe rënie të qëndrueshmërisë mjedisore, duke e bërë edhe më të nevojshëm rikonceptimin e zhvillimit territorial në funksion të demografisë.

Një element veçanërisht i theksuar ishte potenciali i diasporës shqiptare dhe kosovare – një rezervuar i rëndësishëm i kapitalit njerëzor, shkencor dhe financiar, i cili deri tani mbetet i nënshfrytëzuar. Konferenca theksoi nevojën për të kaluar nga qasja e nostalgjisë së diasporës drejt një qasjeje të aktivizimit strategjik të saj në politikat e zhvillimit dhe inovacionit.

Ekonomia shqiptare në dekadën e fundit ka pasur një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe stabilitet makroekonomik duke siguruar një rritje ekonomike prej 3-4 për qind në vit. Por kjo rritje ekonomike nuk është reflektuar si duhet në mirëqenie duke evidentuar mangësi në transformimin e rritjes ekonomike në mirëqenie duke reflektuar pabarazi sociale dhe territoriale. 20 për qind e popullsisë më të varfër merrte vetëm 7.7 % e të ardhurave totale të disponueshme të vendit, ndërkohë që 20 % e popullsisë më të pasur merrte 41.7 % e të ardhurave totale.

2. Evolucioni dhe sfidat e tregut të punës

Në dritën e ndryshimeve të shpejta teknologjike dhe integruese në rajon, tregu i punës po pëson një transformim të thellë strukturor. Shqipëria dhe Kosova po kalojnë nga një ekonomi tradicionale, e mbështetur mbi punën manuale dhe industrinë fason, drejt një ekonomie të dijes dhe teknologjisë digjitale, ku kërkesa për aftësi të reja është rritur ndjeshëm.

Megjithatë, ky tranzicion nuk po shoqërohet me përgatitjen e duhur institucionale. Sistemi arsimor dhe ai i formimit profesional mbeten të fragmentarizuar dhe të pakoordinuar me nevojat e tregut të punës. Papunësia strukturore tek të rinjtë, pabarazitë gjinore, dhe mungesa e trajnimeve praktike po thellojnë hendekun midis kërkesës dhe ofertës për punë.

Një tjetër tendencë që u nënvizua është shfaqja e formave të reja të punës, veçanërisht puna në distancë dhe punësimi përmes platformave digjitale, të cilat po e lidhin rajonin me tregun evropian e global. Në Kosovë, veçanërisht, sektori i TIK-ut dhe i shërbimeve online ka treguar potencial të madh rritjeje, por mungesa e kuadrit ligjor për punën digjitale dhe mbrojtjen sociale mbetet një boshllëk serioz.

Në nivel rajonal, u theksua se ekonomia informale dhe emigracioni sezonal po dëmtojnë ndjeshëm strukturën e tregut të punës dhe të ardhurat publike, duke e bërë të domosdoshme ndërtimin e një arkitekture të re të politikave të punësimit me bazë evidencash dhe parashikime të qarta demografike.

3. Profesionet tradicionale dhe lindja e profesioneve të reja

Një debat i gjerë u zhvillua mbi krizën e profesioneve tradicionale dhe sfidën e përshtatjes me profesione të reja që lindin nga epoka e digjitalizimit dhe inteligjencës artificiale. Sektore si bujqësia, ndërtimi, përpunimi artizanal dhe fasoneria po përballen me mungesë dramatike të punonjësve të rinj, duke rrezikuar trashëgiminë e profesioneve manuale dhe një pjesë të kulturës prodhuese kombëtare.

Në të kundërt, tregu po kërkon profile të reja profesionale në fusha si analiza e të dhënave, inteligjenca artificiale, dizajni digjital, siguria kibernetike, energjia e rinovueshme dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve.

Por kërkesa për këto profesione nuk po përputhet si dhe sa duhet me ofertën e sistemit arsimor, duke krijuar një "vakuum aftësish" të theksuar.

Universitetet dhe qendrat e formimit profesional në Shqipëri dhe Kosovë duhet të kalojnë nga modeli klasik i mësimdhënies teorike drejt një modeli integrues, praktik e ndërdisiplinor, ku bashkëpunimi me biznesin, industrinë dhe sektorin publik të jetë

organik. Kjo kërkon krijimin e mekanizmave të parashikimit të profesioneve të së ardhmes dhe përfshirjen e kompetencave digjitale e të gjelbra në çdo program studimi.

4. Politikat publike dhe qasja institucionale

Konferenca evidentoi se shumë prej sfidave të mësipërme nuk burojnë vetëm nga mungesa e burimeve, por nga mungesa e koherencës së politikave publike dhe dobësia e koordinimit ndërinstitucional. Në të dy vendet, strategjitë për punësim, arsim, zhvillim rural apo digjitalizim veprojnë shpesh në mënyrë të shkëputur, pa një bosht të përbashkët strategjik.

Për të përballuar krizën demografike dhe sfidat e tregut të punës, nevojitet një Strategji e Integruar e Kapitalit Njerëzor, që lidh reformat në arsim, politikat fiskale, investimet publike dhe zhvillimin rajonal. Në këtë kontekst, arsimimi dhe kërkimi shkencor duhet të trajtohen jo si kosto buxhetore, por si investime afatgjata në zhvillim. Një ekonomi e qëndrueshme e së ardhmes do të bazohet mbi bashkëpunimin midis qeverisë, universiteteve, bizneseve dhe diasporës, duke krijuar një ekosistem kombëtar inovativ.

ii. Rekomandimet shkencore

A. Për zhvillimet demografike dhe migracionin

Hartimi i një Strategjie Kombëtare të Rimëkëmbjes Demografike në Shqipëri dhe Kosovë, që përfshin politika stimuluese për lindshmërinë, rikthimin e të rinjve dhe stabilizimin e popullsisë aktive.

Krijimi i një Observatori Rajonal për Demografinë dhe Migracionin, për monitorim dhe analizë të vazhdueshme të flukseve demografike dhe ndikimit të tyre ekonomik.

Zhvillimi i politikave për rikthimin e diasporës profesionale dhe shkencore, përmes instrumenteve fiskale, fondeve të bashkëfinancuara dhe projekteve të mobilitetit qarkor.

Rritja e investimeve në zonat rurale, në infrastrukturë, bujqësi moderne dhe shërbime publike, për të frenuar depopullimin dhe emigracionin strukturor.

B. Për tregun e punës dhe formimin profesional

Themelimi i një Platforme Kombëtare për Aftësitë dhe Punësimin, që lidh kërkesën e tregut me ofertën arsimore në kohë reale.

Zbatimi i politikave aktive të punësimit për të rinjtë, gratë dhe grupet në tranzicion, përmes subvencioneve për punësim dhe programeve të mentorimit.

Nxitja e sipërmarrjes së gjelbër dhe digjitale, përmes fondeve të inovacionit dhe partneriteteve publike–private.

Hartimi i një kuadri ligjor për punën në distancë dhe sigurimin social të punëtorëve të ekonomisë digjitale.

Zhvillimi i një sistemi kombëtar të mësimit gjatë gjithë jetës (lifelong learning),

me platforma online dhe certifikime fleksibël.

C. Për profesionet tradicionale dhe të reja

Krijimi i Qendrave të Trashëgimisë Profesionale për modernizimin e profesioneve tradicionale përmes teknologjisë dhe inovacionit.

Futja e parashikimit të profesioneve të së ardhmes në strategjitë arsimore kombëtare.

Promovimi i programeve duale arsim-punë, në bashkëpunim me industrinë.

Integrimi i kompetencave digjitale, të gjelbra dhe sipërmarrëse në çdo cikël studimi, duke e lidhur edukimin me zhvillimin e qëndrueshëm.

D. Për politikat publike dhe bashkëpunimin rajonal

Hartimi i një Strategjie Rajonale për Kapitalin Njerëzor dhe Inovacionin në Ballkanin Perëndimor, të harmonizuar me agjendën e BE-së 2030.

Krijimi i një Fondi Rajonal të Inovacionit dhe Punësimit Rinor për Shqipërinë dhe Kosovën.

Përshtatja e politikave fiskale për rritje të gjelbër, duke lidhur buxhetin publik me objektivat demografikë dhe ato klimatikë.

Ndërtimi i mekanizmave të koordinimit ndërinstitucional midis arsimit, ekonomisë, bujqësisë dhe teknologjisë.

E. Për arsimin, kërkimin dhe kapitalin njerëzor

Rikonceptimi i universitetit si motor i zhvillimit ekonomik, duke u bërë pjesë aktive e inovacionit dhe tregut të punës.

Rritja e bashkëpunimit mes universiteteve shqiptare dhe kosovare për projekte kërkimore mbi demografinë, migracionin dhe inteligjencën artificiale.

Përfshirja e teknologjive të IA dhe mësimit inteligjent në formimin e mësuesve, ekonomistëve dhe menaxherëve publikë.

Ndërtimi i programeve për kthimin e kapitalit njerëzor përmes mobilitetit qarkor, mentorimit ndërkombëtar dhe projekteve të përbashkëta kërkimore.

III. PËRFUNDIME - REKOMANDIME

Në përfundim të punimeve, Konferenca Ndërkombëtare "Ndryshimet demografike dhe dinamika e tregut të punës – sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Shqipëri, Kosovë dhe Rajon" konkludoi se proceset demografike dhe ekonomike që po ndodhin aktualisht në hapësirën shqiptare dhe më gjerë në Ballkanin Perëndimor përbëjnë një fazë të re dhe kritike të tranzicionit zhvillimor. Plakja e popullsisë, emigracioni masiv, reduktimi i bazës aktive të punës, polarizimi urban–rural dhe ristrukturimi teknologjik i tregut të punës po ndërveprojnë në mënyrë të ndërlikuar, duke vënë në provë kohezionin social, kapacitetet institucionale dhe qëndrueshmërinë e rritjes ekonomike.

Në Shqipëri, reduktimi i popullsisë aktive dhe emigracioni i të rinjve të arsimuar kanë nisur të reflektohen në mungesë të fuqisë punëtore, në rënie të produktivitetit në sektorët tradicionalë dhe në ngadalësim të ritmit të rritjes potenciale.

Në Kosovë, dinamika demografike paraqet një dualitet: nga njëra anë një strukturë e re e popullsisë me moshë të re, që mund të jetë burim zhvillimi; nga ana tjetër, emigracioni ekonomik dhe arsimor po zbraz tregun vendas nga kapitali më cilësor njerëzor. Në të dy vendet, proceset migratore po ndryshojnë profilin e shoqërive: ato nuk janë më vetëm lëvizje fizike të individëve, por rrjete qarkullimi të kapitalit njerëzor, dijes dhe inovacionit, që kërkojnë politika të reja të menaxhimit dhe integrimit.

Në nivel rajonal, Ballkani Perëndimor po përballet me një valë të sinkronizuar transformimesh strukturore, ku dinamika demografike, integrimi europian dhe transformimi digjital po zhvillohen në mënyrë të pabarabartë. Kjo pabarazi krijon tensione të brendshme në tregjet e punës dhe nxit flukse migratore të njëanshme, kryesisht drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, sfidat demografike dhe ekonomike nuk mund të trajtohen më si çështje kombëtare, por si pjesë e një agjende rajonale të përbashkët, që kërkon koordinim të politikave dhe harmonizim të standardeve në fushat e arsimit, punësimit, inovacionit dhe zhvillimit social.

Rekomandime për politika dhe modele të reja për Shqipërinë sugjerohet krijimi i një indeksi kombëtar të mirëqenies (IKM) të ndërtuar mbi modele të njohura dhe të ngjashme në disa vend të BE-së, por i përshtatur me realitetin dhe prioritetet shqiptare. Ky indeks duhet të bëhet baza kryesore për draftimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike në të gjitha fushat.

Politika të fokusuara në reduktimin e pabarazisë: rritja ekonomike duhet të shoqërohet me mekanizma efikase rishpërndarëse. Sistemi tatimor: Forcimi i tatimit progresiv mbi të ardhurat dhe lufta kundër shmangies fiskale. Theksi duhet të vihet te drejtimin e investimeve publike në shëndetësi, arsim të cilësisë së lartë dhe mbrojtje sociale, veçanërisht në zonat e margjinalizuara.

Kërkohet ndërtimi i institucioneve të forta dhe të besueshme, pasi mirëqenia sociale është e lidhur pandashëm me besimin që qytetarët kanë ndaj institucioneve. Forcimi i sundimit të ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe transparenca në vendimmarrje janë parakusht për çdo model të ri zhvillimi. Një shtet i drejtë dhe efikas është garantues i shpërndarjes së drejtë të burimeve.

Modeli i ri i zhvillimit për Shqipërinë duhet të jetë në harmoni me mjedisin. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik nuk mund të arrihet nëse shkurtohen mbulimet natyrore dhe degradohet mjedisi, pasi kjo godet drejtpërdrejt mirëqenien e qytetarëve (shëndeti, cilësia e jetës).

Në mënyrë të veçantë, konferenca vuri në dukje se kapitali njerëzor është faktori përcaktues i zhvillimit në shekullin XXI. Në një epokë të revolucionit teknologjik dhe

automatizimit, aftësia e vendeve të vogla si Shqipëria dhe Kosova për të ruajtur dhe zhvilluar potencialin e tyre njerëzor do të jetë determinante për konkurrueshmërinë e tyre ekonomike dhe për mbijetesën e tyre institucionale. Kjo nënkupton domosdoshmërinë e reformimit të thellë të sistemeve arsimore dhe kërkimore, duke i lidhur ato ngushtë me nevojat reale të tregut të punës dhe me prioritetet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Universitetet duhet të marrin një rol aktiv në hartimin e politikave të punësimit, në përgatitjen e profesionistëve të së ardhmes dhe në ndërtimin e një kulture të mësimit gjatë gjithë jetës. Vetëm në këtë mënyrë mund të kalohet nga modeli reaktiv në një model proaktiv të menaxhimit të ndryshimit.

Një tjetër përfundim i rëndësishëm ishte se migracioni nuk duhet parë vetëm si humbje, por edhe si potencial zhvillimi nëse trajtohet në mënyrë strategjike. Diaspora shqiptare dhe kosovare përfaqëson një kapital të jashtëzakonshëm njerëzor, financiar dhe intelektual, i cili mund të kontribuojë në zhvillimin e inovacionit, të kërkimit shkencor dhe të ndërmarrjeve të reja, përmes politikave të mobilitetit qarkor dhe partneriteteve të strukturuara.

Në këtë kontekst, bashkëpunimi rajonal del si domosdoshmëri historike. Shqipëria, Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor duhet të zhvillojnë një arkitekturë të re të politikave të kapitalit njerëzor, që harmonizon objektivat kombëtare me procesin e integrimit evropian dhe me tranzicionin drejt ekonomisë së gjelbër e digjitale. Vetëm përmes një qasjeje të integruar – që lidh demografinë me arsimin, tregun e punës, zhvillimin rural dhe politikat sociale – mund të ndërtohet një model zhvillimi gjithëpërfshirës dhe rezilient.

Në përfundim, konferenca riafirmoi bindjen se sfidat demografike dhe ato të tregut të punës janë jo vetëm një provë për ekonomitë tona, por edhe një test për kapacitetin institucional, për bashkëpunimin shkencor dhe për vizionin strategjik të politikave publike. Nëse tranzicioni demografik dhe ekonomik menaxhohet me inteligjencë, koherencë dhe guxim politik, atëherë Ballkani Perëndimor mund të shndërrojë sfidat e sotme në shtylla të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Nëse jo, rreziku i boshatisjes demografike, i varfërisë strukturore dhe i polarizimit social mund të minojë themelet e stabilitetit dhe të integrimit evropian të rajonit.

Gjatë 10 viteve të fundit, Shqipëria ka realizuar arritjet të konsiderueshme në zhvillimin ekonomik dhe social: stabiliteti makroekonomik u konsolidua, infrastrukturë dhe mjedisi i biznesit u përmirësua në mënyrë të ndjeshme, dhe turizmi ka njohur një rritje kolosale duke krijuar shumë vende të punës dhe duke ulur varfërinë dhe papunësinë. Këto arritje kanë ndërtuar një platformë për një strategji të re të rritjes ekonomike, e cila mund të krijojë kushtet të përshtatshme për parandalimin e

emigracionit dhe në këtë mënyre ndihmoje qëndrueshmërinë e suksesit ekonomik të vendit. Objektivi kryesor i strategjisë së re të rritjes ekonomike është mbështetja e rritjes në disa sektorë kyç, të cilët kanë potencialin më të madh për përmirësimin e produktivitet ndërmjet masave të synuara me objektiv të heqë pengesat madhore për zhvillimin e tyre.

4 sektorët kyç janë: Bujqësia premium, turizmi i nivelit të lartë dhe turizmi i kaltër, sektori i prodhimit të pjesëve të këmbimit të makinave dhe IT.

Shtyllat e strategjisë së mund të jenë:

- përmirësimi i sistemit arsimor duke marrë parasysh në mënyrë sistematike nevojat e tregut të punës, veçanërisht në sektorët e rinj. Kjo mund të realizohet vetëm ndërmjet një partneriteti me sektorin privat dhe investitorët të huaj.

- Përmirësimi i sistemit shkencor dhe kërkimor: Shqipërisë i duhet një zgjerim i kërkimeve të veta në fushën kryesore, edhe për të realizuar këtë objektiv duhet një partneritet i ri me sektorin privat.

- Përmirësimi i mjedisit të biznesit. Administrata tatimore dhe doganore, licencat dhe të tjera.

- Bashkëpunimi me diasporën shqiptare duke krijuar kushtet e përshtatshme për të tërhequr investimet në sektorët kyç.

Konferenca përmbylli punimet me thirrjen për ndërtimin e një paradigme të re të zhvillimit, të bazuar në dije, në bashkëpunim shkencor e institucional dhe në investim të qëndrueshëm në kapitalin njerëzor – si burimin më të rëndësishëm të progresit ekonomik e shoqëror në hapësirën shqiptare dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor.

www.akad.gov.al

U zhvillua konferenca e dytë ndërkombëtare me temën: "Çështjet e strehimit, planifikimit, zhvillimit rezilient urban dhe territorit: drejt një qasjeje euro-mesdhetare"

Konferenca që u mbajt sot, më 16 tetor 2025, është e dyta në serinë e bashkëpunimeve të Akademisë së Shkencave me Universitetin Polis, COPLAN dhe partnerëve të tjerë vendës dhe ndërkombëtarë në kuadër të kërkimit shkencor e zhvillimit të arkitekturës dhe urbanistikës.

Dita e parë u zhvillua në mjediset e Akademisë së Shkencave me pjesëmarrjen e studiuesve, praktikuesve dhe ekspertëve nga fusha të ndryshme me tematika që ndërthuren në mënyrë organike në ndërtimin e qyteteve dhe territoreve të së ardhmes.

Konferencën e hapi dr. Doriana Musaj, zëvendësdekane e Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, Universiteti Polis.

Dr. Llazar Kumaraku, dekan i Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, Universiteti Polis, përshëndeti pjesëmarrësit dhe shprehu falënderimet e mirënjohjen për organizatorët. Veçanërisht, ai falënderoi kryesinë e Akademisë së Shkencave për bashkëpunimin në organizimin e veprimtarisë.

Akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, mbajti fjalën përshëndetëse në emër të institucionit. Ai u shpreh se në një kohë kur qytetet tona përballen me sfida të shumta nga ndryshime klimatike e deri te presioni i urbanizimit dhe krizat e banesave, forume si ky bëhen hapësira të çmuara reflektimi dhe dialogu shkencor.

"Kontributet e punimeve shkencore që do të paraqiten këto dy ditë, pasqyrojnë përpjekjen për të kuptuar jo vetëm qytetin si strukturë fizike, por si organizëm të gjallë, që ndërlidh historinë, mjedisin ekonominë dhe kulturën njerëzore. Në këtë kuptim konferenca nuk është thjesht një ngjarje akademike por një ftesë për të menduar ndryshe për qytetet tona- si hapësira të bashkëjetesës, inovacionit dhe përgjegjësisë ndaj brezave të ardhshëm." - tha akad. G. Hoxha.

Në fund, ai falënderoi pjesëmarrësit dhe organizatorët dhe u uroi suksese në punimet e kësaj konference.

Seanca e parë plenare nisi me referatet kryesore nga Pantoleon Skayannis, profesor emeritus, Universiteti i Thesalisë dhe Universiteti Polis, Tiranë; Sokol Dervishi, profesor i dizajnit të qëndrueshëm dhe ndryshimeve klimatike në Universitetin Epoka dhe Doris Andoni, eksperte për Politikat e Strehimit dhe Zhvillimin Urban.

Tri seancat e tjera vijuan me prezantimet e punimeve shkencore me tematika të detajuara.

Punët e prezantuara dëshmuan për një frymën kërkimore bashkëkohore dhe ndërdisiplinore në fushën e zhvillimit urban dhe territorial me problematika që shtrihen nga modelet e planifikimit deri te arkitektura klimatike; nga morfologjia urbane historike e qyteteve tona bregdetare si Vlora e Durrësi, tek metropoli ynë Tirana; nga çështjet urgjente të strehimit, planifikimit dhe zhvillimit të tokës në rajonet euromesdhetare te sfidat bashkëkohore të qëndrueshmërisë, lëvizshmërisë së

ndërtimeve tona në kohë zhvillimi normal apo në situata përballë krizash.

Konferenca e dytë ndërkombëtare "Çështjet e strehimit, planifikimit, zhvillimit rezilient urban dhe territorit: drejt një qasjeje euro-mesdhetare" do të vijojë punimet edhe në datën 17 tetor 2025 në mjediset e Universitetit Polis, Tiranë.

www.akad.gov.al

U mbajt Konferenca e 11-të Ballkanike e Informatikës (BCI 2025)

Edicioni i 11-të i Konferencës Ballkanike të Informatikës (BCI 2025) u zhvillua në datat 13-15 tetor 2025 në mjediset e "Tirana International Hotel & Conference Center".

Veprimtaria u organizua nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Universitetin Epoka, Infosoft Systems, DATAPROGNET, MADCOM, MANT, MECO, TBS96.

Ditën e parë të konferencës përshëndeti në emër të Akademisë së Shkencave akad. Neki Frashëri, kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike.

Ishte i pranishëm si kryetar nderi i Konferencës Ballkanike të Informatikës Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, dhe anëtarë të tjerë të kryesisë.

Konferenca u drejtua nga prof. dr. Betim Çiço, Universiteti EPOKA, Shqipëri, dhe prof. dr. Yannis Manolopoulos.

Prof. dr. Isak Shabani, dekan dhe profesor në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike në Universitetin "Hasan Prishtina" të Prishtinës; prof. dr. Radovan Stojanović, profesor i inxhinierisë elektrike në Universitetin e Malit të Zi dhe president i

Shoqatës Malazeze për Teknologjinë e Re (MANT) dhe Yannis Manolopoulos, Universiteti i Nikozisë, Qipro, prezantuan objektivin kryesor të serisë së konferencave.

Një nga objektivat kryesorë është ofrimi e përhapja e arritjeve kërkimore në shkencën kompjuterike dhe teknologjinë e informacionit, që ka si qëllim promovimin, ndërveprimin dhe bashkëpunimin midis shkencëtarëve nga vendet e Ballkanit dhe pjesa tjetër e botës, si dhe inkurajimin për përfshirjen e studiuesve të rinj nga rajoni.

Seancën plenare e çelën të fituarit: prof. dr. Mira Mezini, Universiteti Teknik i Darmstadtit, anëtare e jashtme e ASHSH-së; prof. dr. Panagiotis Sarigiannidis, drejtor i laboratorit ITHACA; Orges Cico, Autronica Fire and Security AS, Norvegji, dhe prof. dr Dragan S. Janković, Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, Universiteti i Nishit.

Konferenca u zhvillua me disa sesione, ku u raportua mbi zhvillimet, rishikimet, propozimet dhe projektet mbi teknologjinë e informacionit në Europën Juglindore në fushat e mëposhtme:

Qeverisja (p.sh.: sistemet në vend, politikat etj.).

Arsimi (çështjet e kurikulave, arsimi i mesëm dhe i lartë etj.).

Çështjet profesionale (p.sh.: punësimi, Shoqëritë e Kompjuterave, sipërmarrja etj.).

Prioritetet Europiane të TIK-ut (p.sh.: ndërmarrjet, specializimi inteligjent, plakja etj.).

Në Konferencën e 11-të Ballkanike të Informatikës u trajtuan temat dhe çështjet e organizimit të pajisjeve dhe sistemeve kompjuterike; rrjetet; inxhinieria e softuerëve; sistemet e informacionit; informatika e përqendruar te njeriu; informatika e aplikuar,

temat sociale dhe profesionale, përpunimi i gjuhës natyrore LLM etj.

U zhvillua shkolla verore e aplikacioneve industriale të sigurisë kibernetike BCI.

Dita e fundit e konferencës u mbyll me vizitat e pjesëmarrësve në parkun e Apolonisë dhe në Manastirin e Zvërnecit.

Veprimtaria u mbajt në vijim të traditës së konferencave ballkanike të informatikës (BCI) të mbajtura në Craiova (2024), Sofje (2019), Shkup (2017), Craiova, (2015), Selanik (2013), Novi Sad (2012), Selanik (2009), Sofje (2007), Ohër (2005) dhe Selanik (2003).

www.akad.gov.al

Për herë të parë në Shqipëri u mbajt takimi vjetor i Grupit Europian të Këshillit Ndërkombëtar të Shkencës (ISC)

Në datat 20-21 tetor 2025 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbajt takimi i 8-të vjetor i përfaqësuesve të akademive dhe institucioneve të tjera kërkimore shkencore europiane, në kuadër të Grupit Europian të Këshillit Ndërkombëtar të Shkencës (ISC) ku Akademia e Shkencave e Shqipërisë është anëtare që nga viti 2009.

Akad. Tarmo Soomere, kryetar i Grupit ISC Europe, anëtar i Akademisë së Shkencave të Estonisë, në hapje të takimit falënderoi Akademinë e Shkencave të Shqipërisë që mikpriti këtë organizim.

Ai e vlerësoi Këshillin Ndërkombëtar të Shkencës (ISC) si organizatën globale shkencore më me ndikim në botë. Ajo bashkon jo vetëm akademitë kombëtare të shkencave, qofshin ato të shkencave natyrore apo të shkencave shoqërore dhe humane, por edhe shumë aktorë të tjerë të rëndësishëm në fushën e kërkimit dhe inovacionit.

Më tej ai tha se qëllimi kryesor i Këshillit të Shkencës është të shprehë dhe të përcjellë zërin e shkencëtarëve në çështjet që kanë të bëjnë me mirëqenien publike globale. I mbështetur nga anëtarët e tij dhe organizata të shumta partnere ndërkombëtare, Këshilli merr pjesë në formësimin e politikës ndërkombëtare të kërkimit dhe promovon ofrimin e këshillave shkencore dhe hartimin e politikave të bazuara në njohuri shkencore. Forca e tij qëndron në bashkimin e zërit të aktorëve të ndryshëm. Si një organizatë botërore, është e natyrshme që ISC-ja të ketë disa pika kyçe rajonale si në Azi dhe Paqësor, në Amerikën Latine, në Karaibe dhe në Europë. Pika të

ngjashme kyçe janë në zhvillim e sipër në Afrikë dhe Lindjen e Mesme. Një detyrë e brendshme dhe e rëndësishme për anëtarët europianë është të përfaqësojnë interesat e institucioneve kërkimore dhe shkencëtarëve europianë në organizatën globale ISC. Kjo nuk është vetëm për të tërhequr vëmendjen ndaj pikëpamjeve dhe nevojave të shkencëtarëve europianë, por më shumë rëndësi ka misioni ynë që të përçojmë zgjidhje të shkëlqyera që kanë funksionuar për Europën në rajone të tjera dhe të paralajmërojmë për rreziqet dhe dështimet e mundshme.

Akad. Soomere tha se një pjesë e madhe e kohës së takimit që mbahet në Tiranë i kushtohet sfidave për shkencën në rajonin ku organizohet takimi. Ky është një tipar i dakordësuar i punës së anëtarëve europianë që fjala t'u jepet rajoneve më pak të njohura. Ky është kontributi i ISC-së drejt forcimit të lidhjeve dhe zvogëlimit të kontrasteve në kontinentin tonë.

Në emër të Kryesisë, fjalën përshëndetëse e mbajti akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ajo u shpreh se Akademia e Shkencave e ka mirëpritur organizimin e këtij takimi të rëndësishëm të përfaqësuesve të akademive dhe institucioneve të tjera kërkimore-shkencore europiane, në kuadër të Grupit Europian të ISC-së.

Si rrallëherë, pas samitit të akademive të rajonit e më gjerë në kuadër të Procesit të Berlinit, zhvilluar tre vjet më parë, mblidhen në këtë sallë përfaqësues të mbi 15

akademive.

Akad. Hoda vuri në dukje se ky organizim është një mundësi e vyer për shkëmbim përvoje e për forcimin e bashkëpunimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me akademitë simotra, duke ndihmuar në afrimin e komunitetit shkencor shqiptar me atë europian në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe globalizimit.

"Takimi zhvillohet në një periudhë tepër domethënëse për zhvillimin e kërkimit shkencor në Shqipëri e për rolin që kërkon të luajë akademia jonë në këtë zhvillim. Në kuadër të negociatave për anëtarësim në BE, dhe arritjes graduale të standardeve europiane, Shqipëria ka adaptuar më 2024-n një strategji të zhvillimit të zgjuar, ku një vend të veçantë zë kërkimi e inovacioni, në konceptimin e së cilës Akademia e Shkencave është një nga hartueset. Me të synohet që financimi i drejtpërdrejtë për kërkimin të arrijë në nivelin e mbi 1% të PBB-së, që për ne do të thotë një hap i madh, si dhe ngritja e disa qendrave kërkimore elitare, kryesisht në nano e bioteknologji, iniciativa këto të ndërmarra prej Akademisë."

Në fund, akad. Hoda vlerësoi rolin dhe veprimtarinë e deritanishme të ISC-së e vullnetin e ASHSH-së për të kontribuuar më tej si anëtare e saj dhe përgëzoi organizatorët që zgjodhën Tiranën për zhvillimin e veprimtarisë.

Takimin e përshëndetën dr. Robert Dumi, drejtor i Programeve Ndërkombëtare pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI); prof. dr. Ilir Kapaj, zëvendësrektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës; prof. dr. Anila Paparisto, zëvendësrektore për anën kërkimore-shkencore Universiteti i Tiranës; prof. dr. Belfjore Qose, kryetare e Akademisë së Rinjve ASHSH; rof. Suela Këlliçi, zëvendësrektore e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; dr. Redion Luli, drejtor i shkollës së doktoraturës në

Universitetin Mesdhetar, të cilët e vlerësuan veprimtarinë si një urë komunikimi mes komunitetit shkencor shqiptar me atë europian.

Prezantimet e seancës së parë plenare i moderoi akad. Tarmo Soomere.

Akad. Ilirjan Malollari, ASHSH, mbajti referatin me temën "Sfidat për shkencën në rajon."

Akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, ASHSH, trajtoi punën e bërë nga Akademia e Shkencave për hartimin dhe botimin e tri projekteve të mëdha: "Historia e shqiptarëve", "Fjalori i Madh i Gjuhës Shqipe" dhe "Enciklopedia Shqiptare".

Akad. Arben Merkoçi, drejtor dhe koordinator i NanoAlb pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, foli online për arritjet në kërkimin shkencor dhe krijimin e urave të bashkëpunimit me institucionet europiane, në rajon më gjerë.

Prof. Manuel de León Rodríguez, Akademia Mbretërore e Shkencave të Sakta, Fizike dhe Natyrore, Spanjë (online) mbajti ligjëratën "Matematika si e mirë publike".

Prof. İlkay Erdoğan-Orhan, Akademia Turke e Shkencave paraqiti punimin për kontributet e fshehura të grave në shkencë.

Seanca e dytë plenare vijoi me diskutimet në panel me tematikën: "Si ta shndërrojmë shkencën si të mirë publike, në motivues të ekonomisë së vendeve të vogla" nga Jūras Banys, president, Akademia e Shkencave e Lituanisë; Zuzana Panczová, zëvendëspresidente, Akademia e Shkencave e Sllovakisë; Muris Čičić, president i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Bosnjës dhe Hercegovinës; Svjetlana Terzic, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Malit të Zi.

Në takimin e grupit europian të ISC-së në Tiranë u paraqitën punime shkencore,

lidhur me historinë e shkencës në Europë dhe lirinë shkencore, si dhe përballja me sfidat e ndryshimeve mjedisore, klimatike dhe teknologjike.

Pjesëmarrësit u përfshinë në debate shkencore, ku u trajtuan sfidat e shkencës, si një e mirë publike globale, me vëmendje në vendet me burime të pakta, roli i teknologjive digjitale, si tendencat që janë intensifikuar vitet e fundit në papajtueshmëri me shkencën, që në thelb është e hapur për ide të reja.

Dita e dytë vijoi me një takim pune vetëm me anëtarët e ISC-së nën drejtimin e akad. Tarmo Soomere.

Fillimisht u miratua procesverbali i takimit vjetor 2024 dhe më pas, akad. Soomere paraqiti Raportin e Grupit të Menaxhimit të Anëtarëve të ISC-së Europiane.

Veprimtaria u mbyll me diskutime për dokumentin "Liria shkencore" dhe vërejtje e sugjerime nga përfaqësuesit e organizatave anëtare të ISC-së Europiane.

Pjesëmarrja e Akademisë së Shkencave si anëtare e një organizate të përmasave globale me mbi 225 anëtarë ka krijuar një perspektivë nxitëse për të përqafuar dhe kontribuar në vizionin që ISC- ja ka në përparimin e shkencës si një e mirë publike.

www.akad.gov.al

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetari i Akademisë së Shkencave, përshëndeti konferencën shkencore mbarëkombëtare: "Muzika shqiptare si krijimtari, interpretim, muzikologji dhe edukim artistik"

-Akad. Gjinushi: "Si kurrë më parë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë nuk ka pasur një përqendrim kaq të madh të përfaqësuesve institucionalë dhe personaliteteve që lidhen me muzikën nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut të mbledhur në këtë konferencë mbarëkombëtare, e para e këtyre përmasave pas viteve 1990"-

-Akad. Gjinushi: "Konferenca do të japë gjetjet dhe rekomandimet e saj për institucionet vendimmarrëse, si një shenjë e bashkëpunimit të ekselencave shkencore e artistike me vendimmarrjen qeveritare, aq të domosdoshme për mbështetjen konkrete në fushën e muzikës, pasi problematikat që hasen ndërlidhen me disa ministri këtu, në Kosovë apo në Maqedoninë e Veriut, si ajo e Arsimit, e Kulturës apo me institucione kombëtare, si: Teatri i Operës dhe i Baletit, RTSH, Universiteti i Arteve, Qendra e Studimit të Arteve etj."-

Fjala përshëndetëse e Kryetarit të ASHSH-së në veprimtarinë e mbajtur sot, më 30 tetor 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë me pjesëmarrjen e personaliteteve të rëndësishme nga Shqipëria e Kosova, si dhe personaliteteve të njohura shqiptare me karrierë ndërkombëtare:

Të nderuar pjesëmarrës,

Si kurrë më parë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë nuk ka pasur një

përqendrim kaq të madh të përfaqësuesve institucionalë dhe personaliteteve që lidhen me muzikën nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut të mbledhur në këtë konferencë mbarëkombëtare, e para e këtyre përmasave pas viteve 1990. Me këtë rast ju uroj të gjithëve mirëseardhjen dhe punime sa më të mbara.

Akademia e Shkencave dhe Fakulteti i Muzikës në UART i kushtuan vëmendjen e duhur propozimit të Komisionit të përhershëm të arteve, pranë saj, që kjo konferencë të organizohej me gjithë seriozitetin dhe mbështetjen e duhur, së bashku me institucionet dhe aktorët më në zë të muzikës sonë brenda e jashtë kufijve shtetërorë, të cilët i falënderojmë që iu përgjigjën thirrjes sonë. Një falënderim të veçantë kemi për Komitetin e Nderit, të cilët i kanë dhënë gjithashtu kësaj konference mbështetjen e tyre profesionale dhe morale.

Ne mblidhemi sot këtu në kohën kur problematikat që shqetësojnë krijuesit dhe interpretuesit e muzikës, edukatorët e saj, që e përcjellin atë përmes edukimit artistik te nxënësit, studentët e më gjerë, e po ashtu studiuesit e muzikologët, janë të mëdha e duhen evidentuar e përballuar. Vrulli i zhvillimeve teknologjike e "çudirat" e inteligjencës artificiale ua lehtësojnë jetën e punën njerëzve duke ua lehtësuar teknikisht, por ato nuk zëvendësojnë rolin e artit dhe të muzikës në jetën e tyre, rol i cili nuk duhet të zvogëlohet, por të rritet. E pikërisht për të vlerësuar rolin e arteve në jetën e vendit e për të adresuar problemet e tij, pranë Akademisë sonë të Shkencave u ringrit dhe funksionon edhe Qendra e Studimit të Arteve, krahas instituteve shkencore tradicionale të albanologjisë.

E gjejmë me vend faktin që konferenca do të japë gjetjet dhe rekomandimet e saj

për institucionet vendimmarrëse, kjo si një shenjë e bashkëpunimit të ekselencave shkencore e artistike me vendimmarrjen qeveritare, aq të domosdoshme për mbështetjen konkrete në fushën e muzikës, pasi problematikat që hasen ndërlidhen me disa ministri këtu, në Kosovë apo në Maqedoninë e Veriut, si ajo e Arsimit, e Kulturës apo me institucione kombëtare, si: Teatri i Operës dhe i Baletit, RTSH, Universiteti i Arteve, Qendra e Studimit të Arteve etj.

Në hapje të kësaj konference është vendi të shprehim nderimin për të gjithë personalitetet që i dhanë zë dhe emër muzikës sonë në shek. XX e që nuk i kemi fizikisht mes nesh, prej at Martin Gjokës, imzot Fan S. Nolit, Thoma Nassit, Kristo Konos, Tefta Tashko Koços, Marie Krajës, Jorgjie Trujës, Kristaq Antoniut, Prenk Jakovës, Gaqo Avrazit, Kostandin Trakos, Mustafa Krantjes, Çesk Zadejës, Tish Daisë, Dhora Lekës, Lorenc Antonit, Fahri Beqirit, Albert Paparistos, Ibrahim Madhit, Ymer Skënderit, Llukë Kaçajt, Tonin Guraziut, Kozma Larës, Hamide Stringës, Tonin Harapit, Pjetër Gacit, Nikolla Zoraqit, Gaqo Çakos, Mentor Xhemalit, Gjon Simonit, Kujtim Laros etj., ndaj të cilëve përkulemi me nderim.

Edhe një herë i urojmë punime të mbara e të suksesshme kësaj konference që i kushtohet muzikës, për të cilën at Gjergj Fishta thoshte: … se termometri i qytetarisë së një populli është muzika... se, sa më fort që muzika të jetë mes kulturës e qytetarisë, aq më të përparuara janë ato.

Ju faleminderit e punime të mbara!

https://www.facebook.com/share/v/1Buzg5Ym9u/

www.akad.gov.al

Mbylli me sukses punimet konferenca shkencore mbarëkombëtare "Muzika shqiptare si krijimtari, interpretim, muzikologji dhe edukim artistik"

Në përfundim të konferencës shkencore mbarëkombëtare "Muzika shqiptare si krijimtari, interpretim, muzikologji dhe edukim artistik", e mbajtur në Tiranë më 30 tetor 2025, pjesëmarrësit, përfaqësues të institucioneve artistike e muzikore organizuese të konferencës nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, me qëllim rritjen e rolit dhe peshës së muzikës shqiptare si krijimtari, interpretim, edukim dhe muzikologji, pasi sollën ekspertizën më të mirë në fushat përkatëse dhe diskutuan problematika, si: mbështetja e mëtejshme e krijimeve dhe interpretimeve muzikore kombëtare, nxitja e kërkimit ndërdisiplinor në fusha specifike, si: muzikologjia dhe etnomuzikologjia, rishikimi i modeleve pedagogjike të mësimdhënies dhe modernizimi i kurrikulave muzikore përmes integrimit të teknologjisë digjitale dhe zhvillimit të kompetencave bashkëkohore për interpretuesit dhe mësuesit, ruajtja dhe digjitalizimi i trashëgimisë muzikore kombëtare, e drejta e autorit, zhvillimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar etj., duke çmuar se kjo përvojë, e mbledhur në këta 35 vjet e dalë gjatë punimeve të konferencës paraqet nevojën të njihet dhe të zbatohet në terren, në emër të institucioneve dhe individëve pjesëmarrës në konferencë, po ju bëjmë të ditur në formë rekomandimesh ndaj institucioneve publike të ngarkuara me ligj, sa më poshtë:

REKOMANDIME

I. Rekomandime në fushën e krijimtarisë muzikore

II. Rekomandime në fushën e interpretimit muzikor

III. Rekomandime në fushën e edukimit artistik muzikor

IV. Rekomandime në fushën e muzikologjisë dhe studimeve muzikore

I. Rekomandime në fushën e krijimtarisë muzikore dhe të interpretimit

1. Të hartohet dhe të aprovohet një Strategji Kombëtare me fokus të veçantë te muzika dhe edukimi përmes saj.

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Ministria e Arsimit)

2. Të krijohet fondi vjetor i mbështetjes së krijimtarisë së re muzikore pranë Ministrisë së Kulturës, në Teatrin e Operës dhe të Baletit dhe në Radio Televizionin Shqiptar dhe të ketë konkurse për krijimtarinë e re muzikore.

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, TKOB, RTSH)

3. Të plotësohet detyrimi i ligjit nr. 10352 "Për artin dhe kulturën", kreu VIII "Tarifat e shpërblimit të cilësisë artistike", neni 34 "Masa dhe kriteret e shpërblimit", ku përmes VKM-së përkatëse duhet të aprovohet masa e shpërblimit të gjinive artistike sipas fushave të artit apo për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike.

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave)

4. Të plotësohet detyrimi i ligjit nr. 10352 "Për artin dhe kulturën", kreu VIII "Tarifat e shpërblimit të cilësisë artistike", neni 34 "Masa dhe kriteret e shpërblimit", ku përmes VKM-së përkatëse duhet të aprovohet masa e shpërblimit për rezultate të larta, të arritura në konkurrime ndërkombëtare për artin e kulturën.

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave)

5. Të plotësohet detyrimi i ligjit nr. 10352 "Për artin dhe kulturën", kreu VIII "Tarifat e shpërblimit të cilësisë artistike", neni 34, ku përmes urdhrit përkatës të ministrit të përcaktohet organizimi i konkurseve kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit.

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit)

6. Të zbatohen realisht të drejtat morale dhe financiare të krijuesve në fushën e muzikës (përmes monitorimit konkret të përdorimit të veprave nga subjektet publike dhe private).

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Financave, RTSH, ALBAUTOR)

7. Të rritet numri i studentëve që studiojnë për kompozicion pranë Fakultetit të Muzikës në UART, duke përdorur praktika të njohura e lehtësi të natyrës administrative për nxitjen e studentëve në kryerjen e studimeve për kompozicion.

(Ministria e Arsimit, UART)

8. Të aprovohet një listë veprash muzikore të krijimtarisë muzikore shqiptare të detyrueshme për t'u njohur dhe interpretuar në shkollat muzikore artistike në vend dhe në Universitetin e Arteve.

(Ministria e Arsimit, UART, Shkollat e Mesme Artistike në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Korçë, Durrës, Fier, Gjirokastër)

II. Rekomandime në fushën e interpretimit dhe transmetimeve muzikore dhe mbështetjen e interpretuesve

1. Statusi i Artistit dhe mbështetja financiare mujore e muzikantëve në profesion të lirë sipas modelit të ligjit francez.

(Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, UART)

2. Ndryshimi i ligjit mbi sponsorizimet nga 2-3% në të paktën 10%, zbritja nga tatimfitimi për bizneset.

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Financave, Kuvendi i Shqipërisë)

3. Krijimi i Fondit Kombëtar për Muzikantët e Rinj – bursë dhe mbulim i blerjeve të instrumenteve muzikore.

(Ministria e Arsimit, UART, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit)

4. Formimi i Orkestrës Rinore Kombëtare, orkestrave rajonale dhe koreve rinore në shkolla dhe universitete, dhe praktikë profesionale të detyrueshme në orkestrat kombëtare për studentët e Akademisë.

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministri i Shtetit për pushtetin vendor, TKOB, Orkestra simfonike e RTSH)

5. Ndërtimi i Rrjetit Kombëtar Muzikor që lidh shkollat me drejtim artistik, Universitetin e Arteve dhe orkestrat muzikore.

(Ministria e Arsimit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, UART, Shoqata e Bashkive)

6. Partneritete publike-private për financimin e muzikës dhe integrimi i muzikës në industrinë digjitale dhe kreative.

(Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministri i Shtetit për pushtetin vendor, Shoqatat e Biznesit)

7. Krijimi dhe mbështetja në vijimësi e festivaleve kombëtare dhe ndërkombëtare që ofrojnë hapësira pune për artistët.

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministri i Shtetit për pushtetin vendor, shoqata e Bashkive)

8. Financim i drejtpërdrejtë i instrumentistëve dhe këngëtarëve të rinj klasikë: subvencione për blerjen e instrumenteve dhe bursë për masterclass jashtë vendit, me detyrimin për të dhënë kontribut në Shqipëri brenda një periudhe 10-vjeçare nga koha e financimit.

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Arsimit, AKKSHI)

9. Program kombëtar "Muzika për të gjithë" – hapja e shkollave 9-vjeçare të muzikës në çdo qytet të Shqipërisë (në çdo 100 000 mijë banorë) sipas parametrave

europianë në lidhje me raportin me popullsinë. Shkollat të kenë kabinetin e muzikës, instrument piano, bateri dhe aparate transmetimi videomuzikore me cilësi stereofonike, si lexues CD-je, videoje apo medie të tjera.

(Ministria e Arsimit)

10. Digjitalizim dhe promovim ndërkombëtar – platformë online ku promovohen talentet shqiptare në nivel global.

(Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministra e Turizmit, Kulturës dhe Sportit)

III. Rekomandime në fushën e edukimit artistik muzikor

1. Të ndërmerren nisma konkrete për zbatimin e 5 të drejtave muzikore bazë dhe të standardeve të "Road map for arts education", dokument i UNESCO-s i aprovuar në konferencën kushtuar edukimit përmes artit, mbajtur në Lisbonë në mars të vitit 2006.

(Ministria e Arsimit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit)

2. Të zbatohen detyrimet që rrjedhin nga "Konventa kuadër e të drejtave të fëmijëve", neni 29 dhe 31, ku theksohet fakti se shtetet duhet të promovojnë të drejtën e fëmijëve për të marrë pjesë në jetën kulturore dhe artistike, si dhe të drejtën për të pasur mundësi të barabarta rikrijuese në të gjitha llojet e formave kulturore dhe artistike, pasi përmes edukimit fëmijët dhe të rinjtë do të ndërgjegjësohen për larminë e formave kulturore dhe përmes tyre do të mund të njohin tjetrin dhe kulturën e tij, për t'i shërbyer një të ardhmeje në paqe dhe zhvillim.

(Ministria e Arsimit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit)

3. Të krijohet Komiteti i Edukimit Artistik, që do të diskutojë dhe sugjerojë politikat e arsimit, muzikës, artit, kulturës dhe përfshirjen e tyre edhe në arsimin parauniversitar e universitar, por edhe në politikat e kulturës, duke krijuar harmoni midis tyre.

(Ministria e Arsimit, Akademia e Shkencave, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit)

4. Të rishikohet Plani Mësimor i Arsimit Parauniversitar 2025, duke rikthyer lëndën e Muzikës në arsimin 9-vjeçar me 2 orë në javë, sikurse ka qenë në Planin Mësimor të vitit 2000-2007.

(Ministria e Arsimit, Akademia e Shkencave)

5. Të rishikohet statusi i normës së mësuesit të arteve në shkollë, duke i mundësuar që këto lëndë të zhvillohen vetëm nga mësuesi specialist nga klasa 1-12.

(Ministria e Arsimit, Akademia e Shkencave)

6. Të rikthehet tradita e konkurrimeve vjetore të ansambleve artistike dhe koreve të shkollave 9-vjeçare dhe gjimnazeve. Për shkollat artistike, një herë në dy-tre vjet të organizohen konkurrime kombëtare në qytete të ndryshme.

(Ministria e Arsimit)

7. Rikonceptimi i programeve muzikore në RTSH publik dhe përmes koncerteve të Orkestrës Simfonike të RTSH-së. Transmetimi i muzikës kombëtare në radiot kombëtare dhe vendore. Shtimi i programeve të edukimit muzikor nga TKOBAP përmes organizimit të "Koncerte për familje".

(Këshilli Drejtues i RTSH, AMA-Autoriteti i Mediave Audiovizive, TKOAB)

8. Krijimi i një muzeu autonom të muzikës pranë institucionit të TKOBAP, ku përmes objekteve muzeore dhe dokumenteve origjinale të paraqitet zhvillimi i muzikës në hapësirën mbarëshqiptare si një institucion i edukimit artistik.

(Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, TKOB)

IV. Rekomandime në fushën e studimeve muzikore e muzikologjisë

1. Themelimi pranë ASHSH-së i një reviste muzikore online.

(Akademia e Shkencave, Komisioni i Përhershëm i Arteve)

2. Krijimi i një portali kombëtar për muzikën shqiptare, një faqe e dedikuar për informacion, analiza, lajme dhe arkiv digjital, që shërben si pikë referimi për studentë, studiues dhe profesionistë të muzikës.

(UART, Qendra e Studimit të Arteve pranë ASHSH)

3. Hapja e programeve të reja të studimit në fushën e etnomuzikologjisë, muziko-terapisë dhe teknologjive digjitale të regjistrimeve audio. Mbështetja e studiuesve të rinj, duke u ofruar mjetet, burimet dhe rrjetet e nevojshme për kërkim shkencor dhe krijimtari muzikore, duke nxitur, mbështetur dhe orientuar studiuesit e rinj.

(Ministria e Arsimit, Akademia e Shkencave, Fakulteti i Muzikës-UART, Akademia e të Rinjve pranë ASHSH)

4. Krijimi i një baze të dhënash për kompozitorët dhe veprat shqiptare, që përfshin biografi, analiza, partitura, regjistrime dhe dokumente historike, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë muzikore kombëtare.

(Qendra e Studimit të Arteve pranë ASHSH, UART)

5. Krijimi i një platforme bashkëpunimi ndërmjet institucioneve arsimore dhe artistike, që lehtëson shkëmbimin e materialeve didaktike, metodologjive të reja dhe projekteve kërkimore.

(Ministria e Arsimit)

6. Krijimi i një biblioteke dhe arkivi shkencor muzikor, që përmbledhin literaturë, partitura, disertacione dhe publikime kërkimore, duke u bërë burim i domosdoshëm për studentët dhe studiuesit e fushës. Bibliotekat publike të kenë fonde të veçanta për blerjen e produkteve muzikore si CD, DVD, partitura dhe parte muzikore.

(Biblioteka Kombëtare, UART Biblioteka, Shoqatat e Bashkive, Qendra e Studimit të Arteve pranë ASHSH)

7. Nxitja e partneriteteve me konservatorë dhe universitete europiane për shkëmbim studentësh, konferenca dhe publikime të përbashkëta.

(Ministria e Arsimit, ASHSH, UART dhe Qendra e Studimit të Arteve pranë ASHSH)

Institucionet pjesëmarrëse

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës
- Komisioni i Përhershëm i Arteve, Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Fakulteti i Muzikës në Universitetin e Arteve
- Qendra e Studimit të Arteve, ASHSH
- Instituti i Antropologjisë Kulturore, ASHSH
- Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH
- Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kosovë
- Fakulteti i Arteve, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni e Veriut
- Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit
- Fakulteti i Muzikës në UP, Kosovë
- Liceu Artistik "Jordan Misja"
- Orkestra simfonike e RTSH
- ASCAP
- Qendra e Kulturës dhe Botimeve të Mbrojtjes, Ministria e Mbrojtjes

Komiteti i Nderit

- Akademik Zeqirja Ballata, Kosovë
- Akademik Rauf Dhomi, Kosovë
- Prof. Thoma Gaqi, kompozitor, Shqipëri
- Saimir Pirgu, këngëtar operistik, tenor
- Rame Lahaj, këngëtar operistik, tenor, Kosovë
- Ervis Gega, Drejtore Artistike e Fondacionit Villa Musica Rheinland Pfalz, Gjermani
- Tedi Papavrami, violinist, profesor në shkollën e lartë të muzikës në Gjenevë, përkthyes, shkrimtar
- Prof. Nora Çashku, pianiste, Shqipëri
- Prof. Rafet Rudi, dirigjent-kompozitor, Kosovë
- Prof. Dr. Thomas Simaku, kompozitor, University of York, Angli
- Prof. Alqi Lepuri, dirigjent, Shqipëri
- Prof. Suzana Frashëri, soprano, Shqipëri
- Prof. Robert Prendushi, muzikolog, Itali
- Prof. Dr. Pirro Miso, etnomuzikolog, Shqipëri
- Florian Vlashi, Violinist dhe drejtues i "Grupo Instrumental Siglo XX", Spanjë
- Dr. Rexhep Munishi, etnomuzikolog, Kosovë
- Dr. Ardian Ahmedaja, Mag. art. Dr. phil. Ardian Ahmedaja (Senior Researcher)

Institute for Folk Music Research and Ethnomusicology of the University of Music and Performing Arts Vienna, Austri

Komiteti Organizativ

• Akad. Prof. Dr. Vasil S. Tole

• Prof. Arben Llozi

• Prof. Asoc. Dr. Rovena Vata Mikeli

• Prof. Asoc. Dr. Armira Kapxhiu

• Dr. Denis Bizhga

Pjesëmarrësit

• Prof. Dr. Zana Shuteriqi-Prela, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë

• Prof. Dr. Fatmir Hysi, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë

• Prof. Asoc. Dr. Rreze Kryeziu Breznica, Fakulteti i Arteve, Departamenti i artit muzikor, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

• Dr. Eno Koço, dirigjent/muzikolog (Senior Teaching Felloë) School of Music, University of Leeds, Angli

• Akad. Prof. Dr. Vasil S. Tole, Zv/Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

• Prof. Valton Beqiri, Fakulteti i Arteve, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

• Prof. Arben Llozi, Dekan i Fakultetit të Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë

• Prof. Endri Sina, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë

• Dr. Blerina Shalari, Instituti i Antropologjisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë

• Msc. Visar Munishi, Dega e Folklorit, sektori i Etnomuzikologjisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kosovë

• Mr. Doc Lejla Alimi Lumani, Fakulteti i Arteve, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni e Veriut

• Prof. Asoc. Dr. Saimir Shatku, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve

• Prof. Asoc. Dr. Holta Sina, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë

• Prof. Petrika Afezolli, Fakulteti i Muzikës, Departamenti Kompozicion-Muzikologji-Dirigjim-Pedagogji, Universiteti i Arteve, Tiranë

• Prof. Blerim Grubi, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

• Prof. Asoc. Dr. Rovena Vata Mikeli, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë

• Dr. Elizabeta Qarri, Fakulteti i Arteve-Universiteti AAB, Prishtinë, Kosovë

• Prof. Pjetër Guralumi, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë

• Prof. Asoc. Dr. Armira Kapxhiu, Fakulteti i Muzikës, Departamenti Kanto, Universiteti i Arteve, Tiranë

• Dr. Eliona Lici, Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë

- Dr. Denis Bizhga, Komisioni i Përhershëm i Arteve, Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Dr. Kreshnik Duqi, Qendra e Studimit të Arteve, Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Prof. Asoc. Dr. Majlinda Hala & Mirela Kamsi-Gurakuqi, Fakulteti i Arteve të Bukura, Universiteti i Arteve, Tiranë & Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)

www.akad.gov.al

Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH

U mbajt mbledhja e Komisionit të mjekësisë

Mbledhjen e mbajtur në datën 29 tetor 2025 e drejtoi akad. Genc Sulçebe, kryetar i Komisionit të mjekësisë.

Sipas rendit të ditës u diskutuan aspektet rregullatore dhe aplikative lidhur me sigurinë e barnave në Shqipëri.

Referuan për këtë temë prof. dr. Suela Këlliçi dhe znj. Blerina Kaza (farmaciste).

U diskutua për hartimin e legjislacionit për garantimin e cilësisë, sigurisë dhe efektivitetit të barnave; komponentin aplikativ dhe menaxhimin e cilësisë së barnave.

Pas diskutimeve, u lanë detyra për reflektim dhe propozime konkrete dhe se si mund të funksionojë më mirë kjo fushë.

www.akad.gov.al

U mbajt mbledhja e Komisionit të Matematikë-Informatikës

Mbledhja e mbajtur në datën 29 tetor 2025 u drejtua nga akad. Fatmir Hoxha, kryetar i Komisionit të matematikë-informatikës.

Sipas rendit të ditës u paraqitën raportet mbi Konferencën e 3-të Kombëtare të Matematikës dhe Konferencën e 11-të Ballkanike të Informatikës.

Në fund të takimit, u bënë diskutime dhe u lanë detyra për të ardhmen, si organizimi i disa konferencave nga ASHSH-ja për shkencat fondamentale dhe zgjerimi i bashkëpunimit me njësitë në projektet kërkimore shkencore. Gjithashtu u bënë propozime për shtimin e anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të rinj të Komisionit të matematikë-informatikës.

Mbledhja u mbyll nga kryetari i komisionit. prof. dr. Hoxha.

www.akad.gov.al

U mbajt mbledhja e Komisionit të fizikë-kimisë

Mbledhjen e mbajtur në datën 13 tetor 2025 e drejtoi akad. Floran Vila, kryetar i komisionit të fizikë-kimisë.

Sipas rendit të ditës u diskutuan: zgjerimi i komisionit me bashkëpunëtorë të jashtëm nga diaspora shkencore shqiptare dhe problematika të programit të studimit të doktoraturës. Akademia e shikon të arsyeshme që t'u.

Komisioni diskutoi gjerësisht dhe me vëmendje çështjet e mësipërme.

Akad. Vila bëri mbylljen e diskutimeve të anëtarëve të komisionit, duke i ftuar në mbledhjet e radhës, tematikat e të cilave u diskutuan paraprakisht.

www.akad.gov.al

Aktivitete të tjera

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u uron përzemërsisht një vit akademik sa më të mbarë e të suksesshëm studentëve dhe pedagogëve

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtarët e saj u urojnë studentëve e pedagogëve, veçanërisht atyre që ulen për herë të parë në auditorët e universiteteve, suksese në rrugëtimin drejt dijes.

Akademia e Shkencave do të mbështesë edhe në këtë vit akademik studentët dhe pedagogët, duke i dhënë më shumë cilësi dhe vlerë kërkimit shkencor për t'u afruar më shumë me universitetet më prestigjioze europiane e botërore.

Gjithashtu, ASHSH-ja do të thellojë bashkëpunimin me universitetet për të rritur performancën në të gjitha aspektet akademike e universitare në funksion të zhvillimit të vendit.

Kryesia e ASHSH-së u uron dhe u shpreh mirënjohje dhe respekt të gjithë akademikëve dhe punonjësve që ka pranë strukturave të saj për punën dhe përkushtimin e tyre në formimin e profesionistëve të së ardhmes.

Të nderuar drejtues të universiteteve në mbarë vendin,

të nderuar studentë dhe pedagogë,

Në vitin e ri akademik, Akademia e Shkencave e Shqipërisë do të vazhdojë t'ju mbështesë për të përmbushur objektivat kërkimorë-shkencorë në të gjitha fushat.

www.akad.gov.al

Filloi punimet dyditore konferenca e 3-të Kombëtare e Matematikës NMC-2025

-Akad. Skënder Gjinushi: Ne do të mbështesim Institutin e Matematikës, i cili u ngrit me synimin për të mbajtur afër si ata që punojnë jashtë dhe ata që punojnë brenda vendit. Ne kemi detyrë të ftojmë kolegët tanë që fizikisht nuk janë këtu, të kontribuojnë në drejtimin e forcimin e shkollës shqiptare të matematikës. Ky është dhe një nga qëllimet kryesore të kësaj konference.-

Konferenca u organizua nga Instituti Kombëtar i Matematikës, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.

Konferenca bëri bashkë matematikanë, profesorë, doktorantë nga universitete dhe institucione shkencore shqiptare e të huaja.

Akad. Neki Frashëri, Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike dhe prof. dr. Fatmir Hoxha, Instituti Kombëtar i Matematikës hapën punimet e konferencës.

Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi, drejtues i komitetit organizator të konferencës, përshëndeti pjesëmarrësit dhe vlerësoi faktin që konferenca mbahet në një kohë që shkencat e matematikës kanë dalë në plan të parë.

Matematika dhe gjuha janë dy shtyllat kryesore të formimit të nxënësve në

shkollë. Duhet theksuar fort se roli i matematikës në shkollë, nuk është thjesht të mësohen disa formula, por të forcohet të menduarit racional.

Akad. Gjinushi shprehu kënaqësinë që ende ka mjaft të rinj, të cilët angazhohen dhe sakrifikojnë që të zgjedhin degën më të vështirë të matematikës si një investim i vyer për të ardhmen. Zhvillimi i kërkimit matematik në Shqipëri nuk ka një traditë të hershme, sepse vetë shkolla shqiptare e matematikës në vendin tonë, e themeluar nga akad. Petraq Pilika, është e re, por megjithatë ka arritur që të realizojë misionin e saj bazë: të kemi një shkollë matematike që formimi i specialistëve të lartë, formimi i të rinjve, formimi matematik në tërësi të jetë i krahasueshëm dhe i konkurrueshëm me homologët. Ky është misioni kryesor, rezultantja e tërë investimit që bëhet në drejtim të matematikës; këtë e dëshmon fakti që shumë të rinj pas viteve 1990 shkuan të studiojnë dhe të punojnë në qendra kërkimore e universitete të tjera, jashtë vendit dhe nuk e ndjenë veten aspak inferiorë, por u konvertuan dhe u përshtatën edhe në nëndisiplina të tjera.

Kryetari i Akademisë së Shkencave e vuri theksin në reformimin dhe strategjitë e kërkimit shkencor në përputhje me ritmet e reja të shkencës në Europë e më gjerë, si dhe në nevojën e shumëfishimit të investimeve në kërkimin shkencor, duke krijuar sektorët e duhur për t'i thithur këto investime.

Ne do të mbështesim punën në këtë drejtim, vetë Institutin e Matematikës, i cili u ngrit me synimin për të mbajtur afër si ata që punojnë jashtë dhe ata që punojnë brenda vendit. Pas 1990-s ishte një avantazh i madh për këdo që shkonte jashtë vendit, por ka qenë edhe një plagë për vendin, sepse shumë njerëz të talentuar u larguan. Nën

ndikimin e tregut të punës, rinia preferoi degët më të lehta e më fitimprurëse duke ulur prurjet në degët e matematikës dhe të shkencave fondamentale në tërësi në universitete. Ndaj ne kemi detyrë të ftojmë kolegët tanë që fizikisht nuk janë këtu, të punojnë në drejtimin e riforcimit të shkollës shqiptare të matematikës. Ky është dhe një nga qëllimet kryesore të kësaj konference. -tha ndër të tjera akad. Gjinushi.

Prof. dr. Eglantina Kalluçi, dekane e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, përshëndeti të pranishmit dhe u ndal në çështjen e zhvillimit të shkencës së matematikës në erën e zhvillimit të inteligjencës artificiale. Matematika, fizika, në tërësi shkencat fondamentale janë ato që ndërtojnë një zhvillim shumë të rëndësishëm.

Opinioni publik dhe shoqëria mbarë duhet të kuptojë se matematika është një shkencë fondamentale dhe duhet kuptuar si e tillë, pa transformime gjatë rrugës. Inteligjenca artificiale, apo shkenca digjitale në përgjithësi i ka themelet në shkencat fondamentale. Ajo që mund të theksojmë nuk është gjë tjetër veçse një mendje e mprehtë me formimin bazë në këto shkenca.

Më tej prof. dr. Kalluçi e vuri theksin në riorganizimin e programeve të studimit në përputhje me atë që kërkon tregu i punës, por pa u cenuar ajo që është formimi bazë fondamental. Zhvillimi teknologjik nuk bën gjë tjetër veçse i vjen në ndihmë zhvillimit të teorive. Të kontribuojmë në zhvillimet e shkencës por duke prekur mendjet e rinisë shqiptare, sepse misioni ynë do të trashëgohet dhe do të japë efektet e tij në brezat që vijnë.

Konferencën e përshëndeti edhe prof. dr. Teuta Myftiu, dekane e Fakultetit të

Inxhinierisë, UT. Ajo vlerësoi punën e bërë për organizmin e konferencës, rëndësinë e saj, dhe shprehu falënderimet për Kryesinë e Akademisë së Shkencave dhe komitetin organizator.

Akad. Neki Frashëri drejtoi seancën e parë të konferencës.

Gjatë seancës prezantuan punimet shkencore akad. Davis Kalaj, Universiteti i Malit të Zi, Podgoricë, anëtar i jashtëm i ASHSH-së; prof. Stefan Janaqi, Shkolla Kombëtare e Mineraleve të Alesit, Francë, si dhe studiues nga universitetet e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Vlorës, Tetovës në Maqedoninë e Veriut, etj.

Gjithashtu u bënë prezantime nga doktorantët me një tematikë të larmishme si analiza funksionale dhe topologjia, algjebra, ekuacionet diferenciale, metoda numerike, fraktalet, probleme didaktike të përdorimit të teknologjisë në arsimin e lartë në përgjithësi dhe atë matematik në veçanti, aplikime etj.

Konferenca do të vijojë edhe ditën e premte, më 24 tetor 2025, në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

www.akad.gov.al

U mbajt forumi me temën "Prodhimi i perimeve në serrë, metodë shumë intensive dhe sfidat aktuale"

Veprimtaria u mbajt sot, më 6 tetor 2025, në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizuar nga Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike dhe Komisioni i Biologjisë, Bujqësisë dhe Veterinarisë i ASHSH-së, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Morën pjesë profesorë dhe studiues nga Italia, Spanja, Greqia, Gjermania dhe Shqipëria, të cilët trajtuan temat më të fundit në prodhimin e perimeve në serra, duke përfshirë inovacionet teknologjike, efikasitetin energjetik, bujqësinë urbane dhe kultivimin pa tokë.

Forumi u moderua nga akad. Nazim Gruda, Universiteti i Bonn-it, Gjermani; Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Në fjalën e hapjes, akad. Gruda përshëndeti të pranishmit dhe e vlerësoi prodhimin e perimeve në serra si një komponent themelor të bujqësisë moderne dhe një nga metodat më intensive dhe më efikase të kultivimit. Ai tha se Shqipëria, si një vend mesdhetar, ka kushte të favorshme për kultivimin e perimeve dhe me menaxhim të duhur, serrat mund të kontribuojnë ndjeshëm në një sektor bujqësor më të qëndrueshëm dhe miqësor me mjedisin. Gjithashtu, foli edhe për shqetësimet që ngre përdorimi intensiv i burimeve natyrore, energjisë dhe inputeve kimike për

qëndrueshmërinë e kësaj metode, të cilat u trajtuan më tej në punimet e këtij forumi.

Akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mbajti fjalën përshëndetëse në emër të Kryesisë. Ajo vuri në dukje se tema që trajtohet në këtë forum është jo vetëm aktuale, por edhe strategjike. Prodhimi në serra është shndërruar në një motor të zhvillimit të bujqësisë intensive, duke mbuluar një pjesë të madhe të nevojave ushqimore të vendit dhe duke krijuar hapësira të reja për konkurrencë në tregjet e jashtme. Por, njëkohësisht, ai na vendos përballë sfidave që lidhen me qëndrueshmërinë mjedisore, përdorimin racional të burimeve natyrore dhe përballimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Akad. Hoda e vlerësoi forumin si një dëshmi të rolit të Akademisë së Shkencave jo vetëm si qendër e dijes, por edhe si urë bashkëpunimi mes kërkimit shkencor, universiteteve dhe politikëbërjes. “Ne synojmë që shkenca shqiptare të mos mbetet vetëm pjesë e debatit akademik, por të shndërrohet në një forcë orientuese për zhvillimin ekonomik, politikat bujqësore dhe strategjitë kombëtare të së ardhmes.”-tha ajo.

Forumin e përshëndeti ambasadori i Spanjës në Shqipëri, z. Gabriel Cremades Ventura. Ai shprehu kënaqësinë për pjesëmarrjen në këtë veprimtari të rëndësishme. Ambasadori e vuri theksin në forcimin e bashkëpunimit shkencor mes Shqipërisë dhe Spanjës për të kontribuuar në zhvillimin e dijes dhe inovacionit dhe veçanërisht në modernizmin e prodhimit në serra, por edhe në sektorët e bujqësisë, industrisë dhe

fusha të tjera të ekonomisë. Z. Cremades rikonfirmoi që përmes këtyre bashkëpunimeve Shqipëria do të mbështetet për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian.

Në fund, përgëzoi organizatorët dhe u uroi suksese në zhvillimin e forumit shkencor.

Nga Ambasada e Greqisë ishte e pranishme znj. Maria Koumoutsakou, kryetare e Zyrës së Punëve Ekonomike dhe Tregtare të Ambasadës së Greqisë dhe z. Efthymios Masouras, sekretar për Punët Ekonomike dhe Tregtare.

Prof. dr. Stefania de Pascale, Universiteti Bujqësor i Napolit "Federico II", Itali, bëri prezantimin e risive për rritjen e qëndrueshmërisë në serrat mesdhetare dhe sisteme të tjera hortikulturore me mjedis të kontrolluar, si rezultat i bashkëpunimit të një ekipi shkencëtarësh që kanë dhënë kontributet e tyre për prodhimin e kulturave serrë në rajonin mesdhetar. Ajo e vuri theksin në gjendjen e teknologjisë dhe perspektivat për sektorin e hortikulturës me mjedis të kontrolluar lidhur me çështjet e qëndrueshmërisë, si dhe në gjendjen e teknologjisë dhe perspektivat për sektorin e hortikulturës me mjedis të kontrolluar.

Forumi vijoi me paraqitjen e punimeve shkencore nga prof. dr. Juan Fernandez, Universiteti Teknik i Kartagjenës, Spanjë; prof. dr. Dimitrios Savvas, Universiteti Bujqësor i Athinës, Greqi; prof. dr. Jesus Ochoa, Universiteti Teknik i Kartagenës, Spanjë; prof. dr. Astrit Balliu dhe Glenda Sallaku, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Shqipëri.

Diskutimet theksuan sfidat aktuale dhe potencialin e bujqësisë së mbrojtur në

Shqipëri dhe në rajonin e Mesdheut, duke nënvizuar rëndësinë e kërkimit shkencor, inovacionit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në fund, u bënë propozime për nisma të reja bashkëpunimi ndërmjet universiteteve dhe institucioneve kërkimore në fushën e hortikulturës dhe bujqësisë së qëndrueshme.

Prezantimet dhe diskutimet i ndoqën me interes fermerë e studentë.

Pas forumit, pjesëmarrësit dhe miqtë e ftuar, të shoqëruar nga akad. Nazim Gruda dhe dy profesorë, vizituan serrat në Divjakë.

www.akad.gov.al

Zhvillohet tryeza shkencore mbi parimin themelor të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Më 2 tetor 2025, Departamenti i Gramatikës dhe i Historisë së Gjuhës, organizoi në sallën "Akademikët" të Akademisë së Shkencave tryezën shkencore mbi parimin themelor të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Në këtë veprimtari morën pjesë përfaqësues të Akademisë së Shkencave, kërkues shkencorë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, profesorë me një kontribut shumëvjeçar në studimet për gjuhën shqipe, si dhe studiues e pedagogë të institucioneve të arsimit të lartë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, të pranishëm në sallë ose përmes platformës Zoom.

Pas fjalës së hapjes nga drejtuesja e Departamentit, në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, përshëndeti akad. Gëzim Hoxha, i cili vlerësoi rëndësinë e mbajtjes gjallë të diskutimeve të vazhdueshme shkencore për çështje themelore të gjuhës shqipe.

Ligjëratën kryesore me temën "Parimi themelor i drejtshkrimit" e mbajti prof. asoc. Aristotel Spiro. Ai argumentoi se debati mbi drejtshkrimin e shqipes nuk mund të japë rezultate të qëndrueshme pa përcaktimin e qartë të parimit themelor.

Prof. Spiro nënvizoi se përveç parimit fonologjik, në drejtshkrimin e shqipes

veprojnë edhe parime dytësore, si parimi fonetik, ndërsemiotik dhe simbolik, të cilët duhen parë në ndërveprim me njëri-tjetrin.

Gjatë veprimtarisë pati pyetje dhe diskutime të shumta nga të pranishmit mbi praninë dhe peshën e këtyre parimeve në gjuhën shqipe, të cilat pasqyruan interesin e lartë të studiuesve dhe nevojën për të vijuar debatin shkencor rreth kësaj çështjeje.

www.akad.gov.al

U promovua monografia shkencore "Edi Rama – Neuroestetika e një artisti" e autorit Oltsen Gripshi

Sot më 14 tetor 2025, Komisioni i Përhershëm i Arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi veprimtarinë për promovimin e monografinë shkencore: "Edi Rama – Neuroestetika e një artisti" të autorit Oltsen Gripshi.

Ishin të pranishëm kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi; anëtarë të tjerë të Kryesisë së ASHSH-së, studiues dhe studentë të arteve.

Moderatorja Suzana Varvarica Kuka, në fjalën e mirëseardhjes e vlerësoi monografinë e autorit Gripshi për risitë në fushën estetike të arteve pamore.

Promovimin e hapi zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave akad. Vasil Tole. Ai e vlerësoi monografinë për qasje shumë të veçanta, siç është neuroestetika, por dhe për veçoritë e procesit artistik të Ramës që Gripshi ka vendosur në fokus të punimit të tij.

“Duke u kthyer te libri i Oltsenit, konstatova me kërshëri se autori arrin të qartësojë çështjen kryesore që njeriu si artist është i përbërë nga një trup i vetëm, ku lidhja e krijimtarisë së tij artistike frymon përmes fenomeneve psikomotorike, të

përbëra nga mendimet, përfytyrimet, ndjenjat dhe gjendjet psikike, të cilat ruhen në nënvetëdijen e artistit dhe përshfaqen e lulëzojnë me krijimin e veprës së artit.

Autori Oltsen Gripshi ka një meritë të veçantë, se synon zbulimin e aktit të pikturimit të Edi Ramës përmes përvojave estetike në nivelin neurologjik, e si i tillë kjo qasje vjen për të parën herë në fushat e studimeve mbi artet pamore shqiptare. Ai e ka parë atë si një shembull unik, do të thosha, për të shpjeguar dhe kuptuar proceset e drejtpërdrejta të krijimit përmes neuroshkencës. Studiuesi e ka parë pikturën e Ramës si një "materie ekzistencialiste pararendëse të imagjinatës", dhe këtë përkufizim e arrin duke iu afruar fenomeneve që studion kjo nëndisiplinë e estetikës së aplikuar." - tha akad. Tole.

Gjithashtu, akad. Tole e vlerësoi librin për ilustrimin me veprën e artistit dhe për tekstin studimor, ku evidentohen disa procese krijuese në pikturë, si: psikika e imazhit, neuroestetika si sintezë e imazhit, estetika semiotike, pavetëdija e gjuhës pamore, si dhe dhjetëra koncepte të tjera, të cilat i referohen perceptimit përmes formulave dhe logaritmeve shkencore.

Veprimtaria vijoi me kumtesat e personaliteteve të shquara të artit dhe mendimit estetik shqiptar.

Prof. dr. Josif Papagjoni referoi rreth vlerave të artistit Edi Rama dhe monografisë së Gripshit. Ai e vendosi krijimtarinë e artistit Rama në plejadën e krijuesve, të cilët pas rënies së komunizmit u shfaqën me një shpërthim të ri artistik si refuzim i butaforisë dhe figurativitetit të realizmit socialist. Ata sollën një model tjetër të

pikturës, që siç e ka quajtur Gripshi, shpjegohet nëpërmjet neuroestetikës, një term i ri që e lëvron Oltseni vetë, i cili e ka mbrojtur doktoraturën në Itali.

Sot me këtë libër, Oltseni ka sjellë një modelim të ri estetik mbi veprën artit, paçka se nuk është shumë vëllimor, por është një libër që mua më duket se sfidon: më së pari për qasjen e tij studimore, estetike, që nuk e kam parë më herët në mendimin kritik shqiptar për pikturën, e cila sot e kësaj dite nuk futet dot në "qelizën" dhe në "protoplazmën" sesi lind imazhi, sesi lind vepra në pikturë. Ai përpiqet në këtë rast ta shikojë veçanërisht Edi Ramën si piktor, larg këndvështrimit si politikan dhe pushtetar. –tha prof. dr. Papagjoni.

Prof. dr. Hivzi Muharremi tha se monografia e autorit Oltsen Gripshi është një vepër që ngrihet mbi një mision të dyfishtë: të afirmojë krijimtarisë e Edi Ramës si artist pamor dhe njëkohësisht ta vendosë atë brenda një kornize teorike moderne, ku psikologjia, filozofia dhe neuroshkenca bashkohen për të shpjeguar përvojën estetike.

Ai vuri në dukje se ky libër paraqitet si i pari studim i plotë mbi artin e Ramës, duke u përqendruar në pikturën e tij dhe duke e interpretuar atë jo thjesht si shprehje individuale, por si një produkt i një ndërthurjeje komplekse midis imagjinatës, pavetëdijes dhe perceptimit njerëzor. Për lexuesin artdashës, libri është një udhëtim që e afron me laboratorin e brendshëm të një artisti bashkëkohor, ndërsa për studiuesit e artit dhe kritikës vizuale ai është një kontribut metodologjik: Gripshi sjell neuroestetikën si mjet për të analizuar artin, duke e pozicionuar Ramën në një traditë të

re të abstraksionizmit lirik pasbashkëkohor.

Studiuesja e artit Suzana Varvarica Kuka u shpreh se më së shumti mendimet e saj rreth këtij libri, lidhen me mendimet e Giuliano Lombardos, i lindur në Romë më 1971-shin, artist dhe profesor i Teorisë së Perceptimit në Akademinë e Arteve të Bukura në Venecia, që shprehet se: “Në procesin e shqyrtimit më të afërt dhe zbulimit se arti mund të marrë çdo formë, si grafika, vizatimi, piktura, skulptura etj, shihet se tipari më dallues i artit nuk është të magjepsë dhe të çudisë publikun në një formë të këndshme, por është të "ndryshojë mendjet e njerëzve".

Këtë përcaktim të Lombardos, studiuesi Gripshi në kapitullin "Estetika semiotike: thelbi gnoseologjik përtej formave" tenton ta thotë në mënyrën e tij kur shkruan se: "Edi Rama e përdor formën...tkurrja e realitetit në thelbin e veçorive të tij elementare reflektohet në interpretimin e tyre përmes gjuhës së stilizuar e të thjeshtëzuar pamore... Një lloj përhumbje brenda një labirinti ngjyrash dhe një assamblage formash të ngjashme me shkrimin kuneiform, ku gjithkush kërkon të zbulojë misterin dhe botëkuptimin që fshihet pas mesazheve".

Të shqyrtosh një vepër arti është vërtet të zbulosh një mister dhe kur zbulon një mister në imazhin e saj, natyrshëm ndryshon mënyrën e të menduarit. Natyrisht, që ta bësh këtë duke përfshirë apo u udhëhequr nga nëndisiplina shkencore, neuroestetika nuk është gjë e thjeshtë dhe e lehtë, është një impenjim neurofilozofik. Mendoj se Oltsen Gripshi ia ka dalë me sukses." - tha studiuesja e artit Varvarica.

Në fund, autori Oltsen Gripshi falënderoi veçanërisht Kryetarin e Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushin për pjesëmarrjen dhe hapësirën që u jepet të rinjve në veprimtaritë e Akademisë së Shkencave; zëvendëskryetarin e ASHSH –së dhe drejtuesin e Komisionit të Përhershëm të Artit, akad. Vasil Tolen, profesorët e studiuesit që morën pjesë në veprimtari, si dhe të gjithë organizatorët e saj.

Për më shumë, shiko linkun:

https://youtu.be/0nË5ZMSLL6Q?si=pSkYILDvfyQTX_Ry

www.akad.gov.al

U mbajt ceremonia e kremtimit të 30-vjetorit të revistës "Studime për artin"

Veprimtaria u mbajt sot më 29 tetor 2025 nga Qendra e Studimit të Arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ceremoninë e kremtimit të 30-vjetorit të revistës "Studime për artin" e çeli drejtori i QSA-së akad. Stefan Çapaliku. Ai paraqiti një historik të shkurtër gjatë tri dekadave të fundit, si dhe perspektivat e zhvillimit të këtij periodiku shkencor në të ardhmen.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi përshëndeti të pranishmit dhe shprehu falënderimet e mirënjohjen për themeluesit e bashkëpunëtorët e revistës. Ai e vlerësoi revistën "Studime për artin", jo vetëm si periodikun më të rëndësishëm shkencor kushtuar çështjeve që kanë të bëjnë me teorinë, praktikën dhe historinë e artit në Shqipëri, por edhe si një pasqyrë të kërkimit shkencor.

Prof. dr. Papagjoni foli për përpjekjet themeltare dhe vijimësinë e botimit të revistës ndër vite. Ai tha se revista ka pasur një vëmendje e posaçme për artin; trashëgiminë dhe traditat artistike të kombit shqiptar, duke iu përkushtuar publikimit të studimeve me tematika që nga periudha e hershme e mesjetës e deri sot.

Në fund përshëndeti dr. Jonida Gashi, kryeredaktore e revistës "Studime për artin". Ajo foli, jo vetëm për indeksimin e revistës në Central and Eastern European Online Library (CEEOL), që është një ndër burimet kryesore të literaturës shkencore nga dhe mbi Europën Qendrore, Lindore e Juglindore në lëmin e shkencave humane dhe sociale, por edhe për punën në lidhje me indeksime të mëtejshme.

www.akad.gov.al

U mbajt tryeza e rrumbullakët me temën "Vendi i gjeografisë teknike në shkencën gjeografike"

Veprimtaria u mbajt sot më 28 tetor 2025 me organizimin e Njësisë së përkohshme të kërkimeve gjeografike, Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, ASHSH.

Tryeza shkencore mblodhi bashkë gjeografë e studiues të albanologjisë dhe të disiplinave të afërta me gjeografinë si: prof. dr. Pal Nikolli, prof. asoc. Ferim Gashi, prof. asoc. dr. Ismail Kabashi, prof. dr. Bilal Draçi, dr. Sami Duraku, dr. Adriatik Balla, dr. Enkela Begu, msc. Florian Fusha, msc. Amir Rexha, msc. Edon Shemsedini, msc. Shkumbin Lushaj.

Hapja e veprimtarisë u bë nga prof. dr. Pal Nikolli. Ai e vlerësoi tryezën shkencore si pjesë të procesit për të krijuar një platformë të integruar të kërkimit gjeohapësinor, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe formimit të brezit të ri të studiuesve që do të udhëheqin tranzicionin digjital të territorit.

Sot, gjeografia teknike - përmes GIS-it, analizës hapësinore, të dhënave satelitore dhe inteligjencës artificiale - është shndërruar në instrumentin kryesor të zhvillimit dhe sigurisë kombëtare. Ne kemi domosdoshmërisht nevojë për analizë të saktë numerike, modelim hapësinor dhe skenarizim prognostik - pikërisht thelbi i gjeografisë teknike, që

i jep shtetit mjetin për të parë të ardhmen.

Mes të tjerash, prof. dr. Nikolli vlerësoi punën drejtuese të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me një vizion të ri: kthimin e gjeografisë në një shkencë të aplikueshme dhe të domosdoshme për shtetin modern.

Prof. dr. Perikli Qiriazi, drejtuesi i Njësisë së kërkimeve gjeografike përshëndeti pjesëmarrësit në emër të Kryesisë së ASHSH-së dhe bordit drejtues të NJKGJ-së dhe i falënderoi për analizën e problemeve komplekse e rezultatet e punimeve shkencore, që lidhen me vendin e gjeografisë teknike në sistemin e shkencave gjeografike.

Ai tha se kjo tryezë shkencore mbyll me sukses realizimin e plotë të programit të aktiviteteve shkencore të vitit 2025 të NJKGJ-së, pranë ASHSH-së, miratuar në shkurt 2025, si strukturë e qëndrueshme kërkimore në fushën e gjeografisë dhe veçoi disa nga arritjet e NJKGJ-së gjatë vitit 2025, si: Forumi "Arkitektura e peizazhit në Shqipëri: sfida e potenciale" dhe CAT International Conference 2025: Qytetet pas tranzicionit etj.

Në fund, prof. dr. Perikli Qiriazi u bëri ftesë studiuesve dhe kërkuesve shkencorë të rinj që të bëhen pjesë e projekteve ambicioze studimore gjeografike, të parashikuara në platformën e NJKGJ-së.

Gjatë punimeve të kësaj tryeze shkencore u trajtuan probleme, arritje dhe sfida të teknologjive moderne të informacionit hapësinor të gjeografisë teknike, të menaxhimit territorial, mjedisor, demografik dhe zhvillimor, si dhe përdorimit të disa teknikave gjeografike në analizat komplekse të burimeve minerale në Kosovë e liqeneve alpine në Shqipëri; monitorimi inteligjent i infrastrukturës së ujit; gjeografia humane bashkëkohore në epokën e teknologjisë së informacionit digjital, si dhe çështje të

analizës gjeohapësinore të potencialit të energjisë, duke përfshirë teknikat e avancuara gjeohapësinore topografike, kartografike, fotogrametrike, sistemit të pozicionimit global (GPS), sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) etj.

Veprimtaria u mbyll me shkëmbimin e mendimeve, konkluzionet dhe propozimet për zbatimin konkret të përparësive të ofruara nga gjeografia teknike në studimet tona gjeografike, për përdorimin e teknikave gjeografike në analizat komplekse gjeografike, për ndërtimin e strategjive e programeve për studime komplekse, gjithëpërfshirëse të problemeve urgjente zhvillimore, mjedisore e më gjerë.

www.akad.gov.al

Takimi me korrektorët e Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe

Projekti i Fjalorit të Madh të Gjuhës Shqipe, i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ndodhet në prag të mbylljes së tij dhe drejtuesi i projektit akad. prof. dr. Valter Memisha, koordinatorja prof. as. dr. Anila Kananaj dhe grupi i korrektorëve (prof. as. dr. Teuta Toska, prof. as. dr. Rozana Rushiti, dr. Olger Brame, dr. Resul Telhaj, dr. Behar Hoxhaj, dr. Engjëllushe Karaj) zhvilluan një takim për të sqaruar dhe zgjidhur çështjet që kanë dalë gjatë punës, si dhe për të nxitur përmbylljen në kohë e me cilësi të këtij procesi. Në takim u përcaktua edhe kalendari i dorëzimit të materialeve për hedhje online te specialistja e programimit të faqes online të Fjalorit, dr. Brikena Liko.

U promovua numri i veçantë i revistës shkencore ndërkombëtare "Polis" kushtuar Shqipërisë dhe shqiptarëve

Veprimtaria u organizua nga dr. Anxhela Cikopano, Qendra e Studimit te Arteve, ASHSH, dhe dr. Oltsen Gripshi, koordinator i botimit të numrit të veçantë të revistës ndërkombëtare shkencore "Polis Albania".

Në promovimin e revistës ishin të pranishëm ambasadorja e Shqipërisë në Rumani, Sh S znj. Enkeleda Baduni Mërkuri; ambasadori i Rumanisë në Shqipëri Sh T z. Octavian Şerban; prof. dr. Sorin Bocancea, zv. rektor i Universitetit "Petre Andrei", Iash, Rumani; prof. dr. Sabin Dragulin, drejtor ekzekutiv i revistës shkencore ndërkombëtare "Polis" dhe profesor në Universitetin "Petre Andrei", Iash, Rumani dhe kryetari i grupit parlamentar të PS, dr. Taulant Balla, dikur student i këtij universiteti.

Përmes ligjëratave të tyre ata shprehën kënaqësinë për bashkëpunimin me autorët dhe institucionet shqiptare që kontribuuan në daljen e këtij numri të veçantë të revistës.

Revista Shkencore Ndërkombëtare "Polis" është botim shkencor i përtremuajshëm i Universitetit "Petre Andrei" të Iashit në Rumani, që përfshin fusha të larmishme shkencore, nga historia e artit pamor shqiptar deri tek shkencat ekonomike, shkencat juridike-politike, arkitektura, gjuhë-letërsia, teatri, kinematografia, trashëgimia kulturore, historia dhe antropologjia.

Botimi i këtij numri të veçantë kushtuar Shqipërisë dhe shqiptarëve u iniciua nga prof. dr. Sabin Dragulin dhe dr. Oltsen Gripshi me aprovim të Senatit Akademik të Universitetit "Petre Andrei" dhe Bordit Shkencor të Revistës Shkencore Ndërkombëtare "Polis".

www.akad.gov.al

Pjesëmarrje të studiuesve të ASHSH në aktivitete

U mbajt në Prishtinë konferenca dyditore ndërkombëtare "Studimet albanistike te sllavët e jugut"

Punimet e konferencës u zhvilluan në datat 27–28 tetor 2025, me organizimin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH).

Kjo veprimtari mblodhi bashkë studiues të njohur nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Bullgaria, Serbia, Kroacia, Rusia, Gjermania etj.

Aktivitetin e hapi akad. Rexhep Ismajli, i cili mbajti edhe referatin kryesor me temën: "Studimet albanistike dhe përgjithësisht shqiptare te sllavët e jugut".

Akad. Gëzim Hoxha mbajti fjalën përshëndetëse në emrin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Ai e vlerësoi takimin, jo vetëm si një përmbledhje studimesh, por edhe si një akt të vetëdijshëm reflektimi mbi mënyrën si është ndërtuar e si vazhdon të ndërtohet njohja për shqiptarin dhe tërësisht për kulturën shqipe në optikën studimore të fqinjëve sllavë.

Akad. Hoxha solli në kujtesë mozaikun e pasur të marrëdhënieve – herë me dialog e herë me tension- që e kanë shoqëruar historinë e mendimit ballkanik nga Jovan Cvijiçi e Franc Miklošiči, tek Milan Shuflai, Fanoula Papazoglou e Pavle Mijovići, tek Rajko Nahtigali, Aleksandar Beliçi dhe Ivan Popoviçi, apo studiuesit më të rinj bashkëkohorë.

Gjithashtu, akad. Hoxha vlerësoi kontributet që vijnë në këtë konferencë nga fushat kërkimore-studimore si arkeologjia, etnografia, muzikologjia dhe historiografia, të cilat tregojnë se albanologjia e sotme është gjithmonë më shumë se sa vetëm një disiplinë gjuhësore e dikurshme. Ai tha se areali i studimeve albanologjike përbën sot një komponente të rëndësishme thelbësore në kulturat e Evropës Juglindore dhe shërben më së miri si një urë ndërlidhëse dhe interpretimi ndërmjet këtyre kulturave.

Gjatë dy ditëve të konferencës u paraqitën mbi pesëdhjetë kumtesa nga studiues të fushave të ndryshme të historisë, gjuhësisë, arkeologjisë, muzikologjisë dhe studimeve kulturore.

Nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe institutet pranë saj paraqitën disa kumtesa:

Akad. Pëllumb Xhufi mbajti kumtesën me temën: “Historiografia e sllavëve të jugut dhe shqiptarët: mes akribisë historike dhe engeneering-ut ideologjik”.

Akad. Adem Bunguri paraqiti kumtesën: "Romaja si model i kërkimit shkencor në arkeologjinë e gjysmës II të shek. XX në Kosovë".

Akad. Gëzim Hoxha mbajti kumtesën me temën: “Pavle Mijović dhe trashëgimia arkeologjike e hapësirës ndërkufitare malazezo-shqiptare”.

Akad. Vasil Tole mbajti kumtesën për kontributin e kompozitorit Bojan Adamič në Shqipërinë e pasçlirimit.

Akad. Shaban Sinani në ligjëratën e tij trajtoi çështje të shqiptarëve bashkëkohës në shkrimet publicistike të Milan Šufflay-t.

Prof. dr. Anila Omari foli për kontributin e Ivan Popovićit për etnogjenezën e shqiptarëve dhe në albanologji.

Prof. dr. Evalda Paci mbajti kumtesën “Rreth vëzhgimeve historike dhe

kulturore të Át Donato Fabianich O.F.M. (një sprovë analitike)".

Prof. asoc. Marenglen Kasmi mbajti kumtesën me temën "Aspekte nga historiografia jugosllave për Shqipërinë gjatë Luftës së Dytë Botërore".

Prof. dr. Aleksander Rusakov u paraqit me kumtesën me titull "Franc Miklošič dhe problemi i adaptimit të huazimeve foljore në gjuhën shqipe".

Prof. dr. Aljula Jubani dhe Ledio Hala paraqitën punimin "Shqipja si faktor aktiv në gjuhësinë ballkanike: Qasja e Aleksandar Belićit".

Prof. dr. Aleksandër Dhima paraqiti kumtesën me temën: "Ndihmesa e Živko Mikićit mbi antropologjinë e ilirëve".

Prof. dr. Mimoza Priku paraqiti kumtesën me temën: "Një qasje për diminutivët e shqipes nga Vojislav S. Dančetovići".

Prof. dr. Dhimitri Bello paraqiti kumtesën me temën: "Një emër i veçantë në studimet bashkëkohore albanologjike në Bullgari: Kontributi i Ekatarina Tarpomanovës".

Më tej, pjesëmarrësit e kësaj konference nga Kosova, vendet e rajonit dhe Europa (sipas programit bashkëngjitur) paraqitën në kontekstin e gjuhësisë historike dhe ballkanistike, trajtesa nga fusha të ndryshme të historisë, arkeologjisë, folklorit e dhe më gjerë që prekin çështje themelore të kontakteve të shqipes me sllavishten, nga huazimet leksikore e fonetike, deri te ndikimet morfosintaksore apo modelet e përbashkëta të frazeologjisë.

www.akad.gov.al

U mbajt konferenca shkencore me temën "Kriza lindore 1875-1878 dhe shqiptarët"

Veprimtaria u mbajt në datën 24 shtator 2025 në Prishtinë me organizimin e Institutit të Historisë "Ali Hadri", Prishtinë, në bashkëpunim me Institutin e Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

Fjalën e hapjes e mbajti prof. dr. Teuta Shala-Peli, drejtore e Institutit të Historisë "Ali Hadri", e cila e vlerësoi konferencën për qasjet e reja mbi zhvillimet politike, diplomatike e shoqërore të një periudhe të rëndësishme (1875–1878) për fatet historike të shqiptarëve dhe u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve.

Akad. Hamit Kaba, drejtor i Institutit të Historisë, ASHSH, Tiranë, mbajti fjalën përshëndetëse. Ai vlerësoi punën e bërë për këtë konferencë dhe shprehu falënderimet e mirënjohjen për bashkëpunimin me Institutin e Historisë "Ali Hadri", Prishtinë....

Akad. Beqir Meta, studiues në Institutin e Historisë, ASHSH, Tiranë, mbajti kumtesën me temën: "Nacionalizmi shqiptar në Shqipërinë e Epërme gjatë viteve 1879–1880". Ai shtjelloi proceset e konsolidimit të nacionalizmit shqiptar në Shqipërinë e Epërme gjatë viteve 1879–1880.

Akad. Marenglen Verli (ASHSH) mbajti kumtesën: "Vlerësimi i shqiptarëve nga Austro-Hungaria si aleatë potencialë në koniunkturat e krizës lindore". Ai sqaroi interesat e Austro-Hungarisë për shqiptarët në kuadrin e strategjive rajonale.

Prof. dr. Ledia Dushku, përgjegjëse e Departamentit të Historisë dhe Konsolidimit të Shtetit Shqiptar në Institutin e Historisë, ASHSH, Tiranë, prezantoi kumtesën me temë "Kriza Lindore dhe bashkëpunimi ballkanik: midis interesave të përbashkëta dhe kufizimeve nacionaliste (1875-1878). Duke marrë si shembull bisedimet shqiptaro-greke, ajo analizoi ndikimin e krizave në stimulimin e përpjekjeve për bashkëpunim ballkanik, si edhe kufizimet strukturore që penguan realizimin me sukses të tyre.

Prof. asoc. dr. Sali Kadria, studiues në Institutin e Historisë, ASHSH, Tiranë, mbajti kumtesën me temë "Interesimi i diplomacisë franceze për krahinën e Mirditës në vitet 70 të shek. XIX. Ai analizoi politikën franceze në kuadrin e Krizës Lindore dhe qëndrimin e mbajtur prej saj ndaj krahinës së Mirditës.

Gjatë dy seksioneve të konferencës u mbajtën kumtesa nga studiues të Institutit të Historisë "Ali Hadri" dhe Universitetit të Prishtinës: akademik Frashër Demaj, prof. dr. Ibrahim Gashi, prof. asoc.dr. Agron Islami, prof. asoc. dr. Mentor Hasani dhe Behar Hyseni, dr. Donika Avdyli dhe dr. Izet Miftari.

Ata trajtuan tema që lidhen me politikën e Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë ndaj çështjes shqiptare në vitet e Krizës Lindore; luftën ruso-osmane dhe rikonfigurimin gjeopolitik të hapësirës ballkanike dhe asaj shqiptare; dhunën dhe shpërnguljet e stimuluara nga lufta ruso-osmane, me fokus shqiptarët e Nishit; si edhe rrethanat sociale dhe ekonomike në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Konkluzionet e konferencës i mbajti akademik Frashër Demaj, shef i Departamentit të Kohës së Re në Institutin e Historisë në Prishtinë.

www.akad.gov.al

U mbajt konferencë shkencore me rastin e 100-vjetorin të rënies së Heroit të Popullit Bajram Curri

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë organizuan konferencën shkencore me temën: "Bajram Curri në Lëvizjen Kombëtare".

Në këshillin organizues nga ASHSH-ja bënin pjesë akademikët Marenglen Verli dhe Beqir Meta, të cilët ishin edhe në grupet drejtuese të zhvillimit të veprimtarisë, ndërsa nga ASHAK-u bënin pjesë prof. dr. Jusuf Bajraktari, prof. asoc. Teuta Shala, prof. dr. Muhamet Mala.

Në konferencë u paraqitën 14 kumtesa.

Akademikët e ASHSH-së Marenglen Verli e Beqir Meta u paraqitën përkatësisht me kumtesat "Bajram Curri në optikën e S. Vllanasit" dhe "Bajram Curri në kontekstin e nacionalizmit shqiptar gjatë viteve 1920-1924". Kumtesat u mirëpritën për risitë në faktologji e interpretim.

Prof. dr. Frashër Demaj, prof. dr. Jusuf Bajraktari, prof. asoc. Teki Kurti, prof. dr. Fehmi Rexhepi, prof. dr. Muhamet Mala, dr. Islam Lauka, prof. asoc. Teuta Shala, Endrit Musai, Mark Palnikaj, Lush Culaj, Luan Tetaj, Shkodran Ymeraj, Zake Prelvukaj, Ismet Jonuzi nëpërmjet kumtesave të tyre evidentuan rolin dhe vendin e heroit Bajram Curri në lëvizjen kombëtare.

Akad. Beqir Meta mbajti fjalën e mbylljes së konferencës dhe vlerësoi rezultatet e këtij eventi shkencor.

Për më shumë, shih linqet:

https://www.youtube.com/ëatch?v=iiRrN55të9g

https://www.youtube.com/ëatch?v=uL8u7mKGhKk

Biblioteka e Akademisë së Shkencave në 90-vjetorin e Bibliotekës Publike "Mitrush Kuteli", Pogradec

Biblioteka e Akademisë së Shkencave mori pjesë në aktivitetin jubilar të organizuar me rastin e 90-vjetorit të krijimit të Bibliotekës Publike "Mitrush Kuteli" në Pogradec, një nga bibliotekat më të vjetra dhe me traditë në vend.

Takimi mblodhi së bashku përfaqësues të bibliotekave publike, universitare dhe speciale nga mbarë Shqipëria, si dhe përfaqësues të institucioneve vendore e qendrore.

Veprimtarinë e përshëndetën përfaqësues të Bashkisë Pogradec, Prefekturës së Qarkut Korçë, Këshillit të Qarkut Korçë, si dhe drejtues e punonjës të bibliotekave, studiues, dashamirës të librit dhe familjarë të shkrimtarit të njohur Mitrush Kuteli.

Në këtë veprimtari, midis të tjerash, u vlerësua roli i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në pasurimin e fondit të bibliotekave të vendit përmes botimeve të saj shkencore, të cilat kanë ndihmuar në zhvillimin e kërkimit, studimit dhe leximit në institucionet publike, universitare dhe kërkimore.

Për këtë kontribut të qëndrueshëm në fushën e dijes dhe kulturës, Biblioteka "Mitrush Kuteli" i dorëzoi "Certifikatën e mirënjohjes" Akademisë së Shkencave.

Në fjalën përshëndetëse, drejtuesja e Bibliotekës së Akademisë së Shkencave, dr. Albana Velianj, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm mes bibliotekave në shkëmbimin e eksperiencave dhe pasurimin e burimeve të dijes.

BASHKIA POGRADEC

QENDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC sh.a

Biblioteka Publike
"Mitrush Kuteli"

Certifikatë

MIRËNJOHJE

I jepet AKADEMIA E SHKENCAVE në shenjë mirënjohje të thellë për kontributin e vyer, nëpërmjet dhurimit të librave që pasurojnë fondin e Bibliotekës sonë. Ky akt bujarie ndihmon në nxitjen e dashurisë për leximin në komunitetin tonë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Kryetari
ILIR XHAKOLLI

Ajo nënvizoi gjithashtu vazhdimësinë e kontributit të Akademisë së Shkencave në mbështetje të bibliotekave universitare, publike dhe speciale, për pasurimin e fondit të tyre me botime shkencore që forcojnë misionin e bibliotekave në fushën e kërkimit, studimit dhe përhapjes së dijes.

www.akad.gov.al

Konsorciumi i Bibliotekave të Shqipërisë në Asamblenë e Përgjithshme të EIFL (Electronic Information for Libraries) 2025

Konsorciumi i Bibliotekave të Shqipërisë mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të EIFL (Electronic Information for Libraries) 2025, një ndër ngjarjet më prestigjioze ndërkombëtare që mbledh drejtues bibliotekash, konsorciume dhe institucione kërkimore nga mbarë bota për të ndarë përvoja, praktika dhe vizione mbi qasjen e hapur dhe inovacionin në fushën e bibliotekave.

Këtë vit, Asambleja u zhvillua në datat 30 shtator – 2 tetor 2025, në Bibliotekën Kombëtare të Jerevanit, Armeni.

Shqipëria u përfaqësua nga dr. Albana Velianj, Koordinatore e Përgjithshme e Konsorciumit të Bibliotekave të Shqipërisë dhe drejtuese e Bibliotekës së Akademisë së Shkencave dhe znj. Jorida Tollkuçi, drejtuese e Bibliotekës Publike "Thimi Mitko" të Korçës.

Punimet e Asamblesë u përqendruan në disa tematika kyçe si forcimi i bashkëpunimit ndërmjet konsorciumeve bibliotekare, sigurimi dhe shpërndarja efikase e burimeve elektronike si dhe përmirësimi i cilësisë së publikimeve shkencore me qasje të hapur. Përvojat e ndara nga universitete prestigjioze të Francës dhe Holandës u

shërbyen pjesëmarrësve si modele frymëzuese për zhvillime të reja.

Dr. Velianj kontribuoi me prezantimin e saj mbi rolin e bibliotekave shqiptare në nxitjen e qasjes së hapur. Në këtë kontekst rëndësi merr shpërndarja e burimeve elektronike për bibliotekat universitare dhe publike, si dhe organizimi i trajnimeve për bibliotekarët për përdorimin e tyre në funksion të kërkimit shkencor dhe procesit mësimor universitar.

Electronic Information for Libraries (EIFL) është një organizatë ndërkombëtare që vepron në 40 vende në mbarë boten, me misionin për të zgjeruar aksesin ndaj njohurive. Ajo mbështet bibliotekat dhe konsorciumet bibliotekare në negociimin e licencave për burime elektronike shkencore, promovimin e publikimeve me qasje të hapur dhe zhvillimin e kapaciteteve për inovacion në shërbimet bibliotekare. Përmes veprimtarisë së saj, EIFL ndihmon institucionet akademike, kërkimore dhe publike të vendeve anëtare të ofrojnë mundësi më të barabarta për studim, kërkim dhe zhvillim.

Duhet theksuar se Akademia e Shkencave luan një rol thelbësor në anëtarësimin e Shqipërisë në EIFL, duke mundësuar akses çdo vit në burime elektronike të domosdoshme për kërkimin shkencor, për ngritjen e cilësisë së studimeve dhe për procesin e akreditimit universitar.

Në kuadër të strategjisë kombëtare për shkencën e hapur, Konsorciumi i Bibliotekave të Shqipërisë mbetet një partner i pazëvendësueshëm, duke vepruar si negociator kryesor për sigurimin e burimeve ndërkombëtare dhe duke mbështetur autorët shqiptarë në botimet me qasje të hapur.

www.akad.gov.al

U mbajtën punimet e konferencës shkencore ndërkombëtare me tematikë "Studimet albanistike te sllavët e jugut"

Në datat 27-28 tetor 2025 në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës u mbajtën punimet e konferencës shkencore ndërkombëtare me tematikë "Studimet albanistike te sllavët e jugut", organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Në këtë konferencë prof. dr. Aleksander Rusakov (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë) u paraqit me kumtesën me titull "Franc Miklošič dhe problemi i adaptimit të huazimeve foljore në gjuhën shqipe";

prof. dr. Anila Omari (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë) u paraqit me kumtesën me titull "Idetë e Ivan Popovićit për etnogjenezën e shqiptarëve dhe kontributi i tij në albanologji";

prof. as. dr. Evalda Paci (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë) u paraqit me kumtesën me titull "Rreth vëzhgimeve historike dhe kulturore të Át Donato Fabianich O.F.M. (një sprovë analitike)".



Kontributet e paraqitura në këtë konferencë patën një shtrirje të gjerë në pikëpamje disiplinash, duke përfshirë arkeologjinë, historinë, muzikologjinë, gjuhësinë, letërsinë, filologjinë, etnologjinë, antropologjinë, studimet e krahasuara.

Prof. as. dr. Rovena Vata Mikeli mori pjesë në Konferencën shkencore "Personalitete dhe figura me vlera shkencore dhe kulturore shqiptare nga Lugina e Preshevës dhe viseve të tjera shqiptare

Më datë 25 tetor 2025, prof. as. dr. Rovena Vata Mikeli, punonjëse shkencore e Departamentit të Studimeve Letrare, pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, mori pjesë në Konferencën shkencore "Personalitete dhe figura me vlera shkencore dhe kulturore shqiptare nga Lugina e Preshevës dhe viseve të tjera shqiptare", e organizuar nga SHOQATA PËR TRASHËGIMI DHE KRIJIMTARI KULTURORE E LUGINËS SË PRESHEVËS, mbajtur në Preshevë.

Prof. as. dr. Rovena Vata Mikeli u paraqit me kumtesën me titull: "DRITËRO AGOLLI BARD I PËRJETSHËM I POEZISË SHQIPE". Një përmbledhje të kësaj kumtese po e paraqesim më poshtë.

Poetika shqiptare nuk mund të quhet e përmbushur pa emrin e Dritëro Agollit, pa krijimet e tij dhe pa prurjet poetike ndër vite në letërsinë shqipe. Ai hyri në historinë e letërsisë shqipe si poet, ku bie në sy afërsia e tij me lexuesin e vet, një poet, i cili dhimbjen, gëzimin dhe trishtimin i shihte si ndjenja universale, duke i shkrirë me filozofinë e jetës së përditshme. Dritëro Agolli është shkrimtar vijues i traditës më të mirë krijuese shqiptare, duke e pasuruar me vlera të mirëfillta letrare dhe kulturore. Dritëro Agolli i këndoi dashurisë së tokës ku u rrit, njeriut të thjeshtë, gjuhës shqipe, sinqeritetit dhe komunikimit njerëzor, ndjenjave shpirtërore dhe virtyteve njerëzore, si: dashurisë, besimit, shpresës, mirësisë, gëzimit, bujarisë, pasionit, mërzisë, braktikjes,

vetmisë, por edhe proceseve jetësore të vetë njeriut, si: fëmijërisë, rinisë, pjekurisë, pleqërisë, vdekjes.

Dashuria në poezitë e Dritëro Agollit shndërrohet në kult, teksa përshkruan ndjenjat më të forta të njeriut si përjetime universale. Muzën e tij poetike Dritëro Agolli e gjente në çdo cep të Shqipërisë. Poezia e tij vazhdimisht reflekton ngrohtësi shpirtërore. E bukura në poezinë e Dritëro Agollit krijon një vlerë shpirtërore të fuqisë së qëndrueshmërisë dhe durimit, të sfidës ndaj kohës dhe një lloj urtësie, që vjen nga përvoja e jetës. Sa herë që ai ndryshonte stilin, në mënyrë të jashtëzakonshme e ruante individualitetin artistik dhe përmbajtjen emocionale të poezisë, për këta dhe shumë të tjera, DRITËRO AGOLLI MBETET BARD I PËRJETSHËM I POEZISË SHQIPE.

Prof. as. dr. Evalda Paci mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare me tematikë qendrore "Qasje ndërdisiplinore, sinergji dhe risi në shkencat humane dhe shoqërore"

Më datën 21 tetor 2025, prof. as. dr. Evalda Paci, përgjegjëse e Departamentit të Studimeve Letrare (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë) mori pjesë në konferencën shkencore ndërkombëtare me tematikë qendrore "Qasje ndërdisiplinore, sinergji dhe risi në shkencat humane dhe shoqërore", organizuar nga Departamenti i Romanistikës- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi") në bashkëpunim me Fakultetin e Gjuhëve dhe Shkencave Humane dhe Institutin e Gjuhëve dhe të Letërsive Evropiane (Universiteti Haute-Alcase, Francë). Evalda Paci u paraqit me kumtesën "Kultura librore në një vështrim ndërdisiplinor dhe analitik (modele përpilimesh dhe veprash të shekullit XVI- XVIII)", duke pasur si objekt trajtimi njohjen e vatrave më të hershme të editorisë në arealin italik si dhe qarkullimin e ruajtjen e disa ekzemplarëve librorë që dëshmojnë dhe arritjet më të para në realizimin e varianteve të shtypura të veprave të letërsisë antike dhe

kishtare në këtë të fundit. Pjesë e kësaj trajtese ishin disa vepra në gjuhën latine, ndër të cilat "De oratore" e Ciceronit, "Ars Grammatica" e Donatit, si dhe përpilime të tjera me autorë si Lattanzi (De divinis institutionibus), Shën Agostini (De civitate Dei), që janë pjesë e sprovave më të para të prototipografëve gjermanë (C.Sëeynheym, A.Pannartz) të vendosur në arealin italik në vitet 1464-1465, të rimarra dhe në studimet më të fundit ndërdisplinore mbi inicimin e shtypshkrimit në disa qendra të njohura të kulturës librore. Kultura e librit të shtypur në arealin italik në shekujt XVI-XVII ka si pjesë të panoramës përkatëse dhe realizimin e veprave të letërsisë së vjetër shqipe, duke qenë se për një pjesë të tyre disponohen dhe indice të qarta mbi vendin e botimit dhe tipografitë përkatëse, si pjesë e institucioneve të lëvrimit libror dhe të mbikëqyrjes së prodhimtarisë së veprave me një tematikë të paracaktuar.

Prof. as. dr. Rovena Vata Mikeli ishte e ftuar në aktivitetin përkujtimor kushtuar 125 vjetorit të ndarjes nga jeta të poetit të madh të rilindjes, Naim Frashërit

Më datë 20 tetor 2025, prof. as. dr. Rovena Vata Mikeli, punonjëse shkencore e Departamentit të Studimeve Letrare, pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, ishte e ftuar në aktivitetin përkujtimor kushtuar 125 vjetorit të ndarjes nga jeta të poetit të madh të rilindjes, Naim Frashërit, veprimtari kjo e organizuar nga Qendra Kulturore "Aleksandër Moisiu", Durrës.

Prof. as. dr. Rovena Vata Mikeli u paraqit me kumtesën me titull: "Naim Frashëri në letrat shqipe". Një përmbledhje të kësaj kumtese po e paraqesim më poshtë.

Në këtë 20 tetor të vitit 2025, kujtojmë me nderim, respekt e dashuri, emrin dhe veprën e Naim Frashërit, poetit tonë kombëtar, mendimtarit dhe veprimtarit të shquar të arsimit e kulturës shqiptare, arkitektit të Rilindjes sonë Kombëtare, hartuesit të teksteve në gjuhën shqipe, ideologut të shquar të filozofisë bektashiane, dashuronjësit të flaktë të gjuhës shqipe dhe flakadanit të Shqipërisë europiane.

Te krijimtaria letrare e Naim Frashërit qëndrojnë bashkë në kuvendim të përhershëm gjuha shqipe dhe viset shqiptare, miti dhe historia, etnosi dhe qytetërimi, ndjenja atdhetare për Shqipërinë dhe ndjenja për të bukurën si vlerë estetike.

Poezia e Naim Frashërit është poezi filozofike, poezi atdhetare, ku zënë vend edhe poemat heroike dhe proza filozofike, për të mos harruar një tjetër kontribut të çmuar të Naim Frashërit në letërsinë shqipe, lëvrimin e prozës dhe poezisë për fëmijë,

ku përmes vargut e frazës shqipe, përcillen mesazhe të nivelit më të lartë artistik dhe universal, për botëkuptimin e fëmijëve dhe miredukimin e tyre.

Bilbili i gjuhës shqipe dhe mjeshtri i fjalës së shkruar, poeti i madh kombëtar Naim Frashëri, përgjatë periudhës së angazhimit të tij në letërsi, vuri bazat e gjuhës letrare kombëtare, vepra e tij poetike luajti rol në zgjimin e vetëdijes atdhetare kombëtare.

Tradita që krijoi Naim Frashëri është e gjallë dhe frymëzuese edhe në jetën e shoqërisë sonë të sotme, pasi ai vazhdimisht është vlerësuar nga kritika si një mendimtar dhe veprimtar i shquar i Rilindjes sonë Kombëtare.

Botëkuptimi i Naim Frashërit ishte në thelb panteist e idealist dhe e gjithë veprimtaria e tij letrare e kulturore ishte e lidhur ngushtë me çlirimin dhe përparimin e vendit, me çlirimin shpirtëror dhe ndriçimin e mendjes së popullit shqiptar.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij, në kujtesë, në fjalë, në mendime dhe në shkrimet shqipe!

Dr. Valbona Sinanaj ka kryer një praktikë të shkurtër kërkimore - shkencore, pranë Universitetit të Kalabrisë (UNICAL)

Në periudhën nga 1 – 14 tetor, Dr. Valbona Sinanaj, kërkuese pranë Departamentit të Gramatikës së Sotme dhe Historisë së Gjuhës Shqipe, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), me specialitet Fonetikë e Fonologji, pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ka kryer një praktikë të shkurtër kërkimore - shkencore, pranë Universitetit të Kalabrisë (UNICAL).

Praktika u zhvillua në Laboratorin e Fonetikës, drejtuar nga prof. Luciano Romito.

Gjatë praktikës ajo pati mundësinë:

- Të marrë pjesë në vëzhgimin e seksioneve të analizave fonetike instrumentale;
- Të njihet me metodologjitë e kërkimit të aplikuar në fonetikën eksperimentale;

- Të thellojë njohuritë në përdorimin e mjeteve softuerike për analizën akustike të gjuhës së folur;
- Të nisë një dialog shkencor me studiuesit e laboratorit, duke favorizuar shkëmbimin akademik midis dy institucioneve;
- Të kryejë matje akustike të gjatësisë së zanoreve në gjuhën shqipe.

Prania e saj qe një rast i mirë për pasurim të ndërsjellë kërkimor, duke kontribuar në forcimin e marrëdhënieve midis Universitetit të Kalabrisë dhe Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Pof. as. dr. Rovena Vata Mikeli mori pjesë në aktivitetin përkujtimor kushtuar jetës dhe veprës së shkrimtarit Dritëro Agolli, me rastin e ditës së tij të lindjes: "Dritëro Agolli dhe universaliteti në veprën e tij"

Më datë 13 tetor 2025, prof. as. dr. Rovena Vata Mikeli, punonjëse shkencore e Departamentit të Studimeve Letrare, pranë Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (Akademia e Shkencave e Shqipërisë), mori pjesë në aktivitetin përkujtimor kushtuar jetës dhe veprës së shkrimtarit Dritëro Agolli, me rastin e ditës së tij të lindjes: "Dritëro Agolli dhe universaliteti në veprën e tij", organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe të Leximit.

Prof. as. dr. Rovena Vata Mikeli u paraqit me kumtesën me titull: "Universalja në krijimtarinë poetike të Dritëro Agollit". Një përmbledhje të kësaj kumtese po e paraqesim më poshtë.

Në 13 tetor të vitit 1931 në Menkulas të Devollit, lindi gjeniu i letrave shqipe, Dritëro Agolli, një nga poetët, që i dha zë letërsisë shqipe, tek i cili dallohej aftësia për të shfaqur thjeshtësinë e vagut poetik me thellësinë emocionale e artistike. Poezia e Dritëro Agollit është e shkruar brenda Shqipërisë dhe realitetit kulturor e social shqiptar, por vargu i tij poetik prek tema universale, që i përjeton çdo njeri pavarësisht kulturës përkatëse apo kufijve gjeografikë. Dritëro Agolli në vargun e tij poetik trajton tema, që i

përkasin përvojës njerëzore, të cilat përfshijnë çdo kulturë, vend, komb, ku mund të përmenden: a) tematika njerëzore dhe të përjetshme, si: dashuria, malli, vetmia, dhimbja, fitorja, humbja, frika; b) figurat universale, si: Njeriu, toka, nëna, babai, gruaja; c) tema filozofike, si: Jeta, vdekja, koha etj. Pra Dritëro Agolli në vargun e tij poetik tejkalon kufijtë kombëtarë, kohorë dhe kulturorë, duke trajtuar tema, ndjenja dhe përvoja, që janë të përbashkëta për gjithë njerëzimin.

Vizitë pune

Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi pret në një vizitë zyrtare drejtorin e Institutit për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, dr. Besnik Eminin

Takimi u zhvillua sot më 13 tetor 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Ishin të pranishëm, zëvendëskryetari i ASHSH-së, akad. Vasil Tole dhe dr. Ardian Limani, bashkëpunëtor shkencor në ITSHKSH.

Ky takim u organizua në vijim të bashkëpunimit të vazhdueshëm të ASHSH-së me ITSHKSH-në.

Akad. Gjinushi dhe drejtori i ITSHKSH-së, Shkup, dr. Emini, diskutuan për iniciativa të përbashkëta dhe për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në fusha me interes të ndërsjellët.

Palët shprehën mirëkuptimin që raportet e bashkëpunimit të forcohen e të thellohen më tej edhe në të ardhmen.

Akademia e Shkencave ka vendosur një bashkëpunim të qëndrueshëm me Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të shqiptarëve në Maqedoninë e

Veriut, kjo e formalizuar edhe me një marrëveshje institucionale. Veprimtari të përbashkëta, konferenca e projekte janë zhvilluar e priten të mbahen më tej.

Ndër to është edhe angazhimi i kërkuesve shkencorë të ITSHKSH-së në projektet madhore në albanologji që drejton ASHSH-ja dhe ASHAK-u, sidomos në projektin e "Historisë së shqiptarëve" dhe "Enciklopedisë shqiptare", ku do të japin ndihmesën e tyre edhe kërkuesit shkencorë të ITSHKSH-së. Në takim u përcaktuan modalitetet e bashkëpunimeve të tjera në të ardhmen, ku ASHSH dhe institutet dhe qendrat pranë saj do mbështesin nismat që ISHTKSH-ja do të ndërmarrë për studimin dhe dokumentimin e pasurisë së madhe të popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut në fusha si muzika popullore, arkitektura dhe kostumografia.

www.akad.gov.al

Të reja nga bota akademike

U mbajt konferenca e 9-të e përbashkët shkencore në kuadër të Procesit të Berlinit 2025, Shkenca nën presion: sfidat dhe mundësitë; Lubjanë, Slloveni

Në datat 14-16 tetor 2025 u zhvillua konferenca e 9-të e përbashkët shkencore me temën "Shkenca nën presion – sfidat dhe mundësitë" në Lubjanë, Slloveni.

Në këtë konferencë Akademia e Shkencave e Shqipërisë u përfaqësua nga akad. Anila Hoda, sekretarja shkencore, dhe prof. asoc. dr. Elda Zotaj, shefja e marrëdhënieve me jashtë dhe publikun.

Që nga viti 2015, Procesi i Berlinit përfshin një shtyllë të dedikuar për shkencën, arsimin, kërkimin, inovacionin dhe transferimin e njohurive, e cila koordinohet nga Akademia Kombëtare Gjermane e Shkencave "Leopoldina". Çdo vit, në kuadër të kësaj shtylle, organizohet Konferenca e Përbashkët Shkencore e Procesit të Berlinit, e cila kurorëzoi organizimin e saj të 9-të duke bërë bashkë akademikë, ekspertë dhe aktorë institucionalë nga vendet pjesëmarrëse.

Organizatorë të kësaj konference ishin Akademia Kombëtare e Mbretërisë së Bashkuar "The Royal Society" dhe ajo e Gjermanisë, "Leopoldina", në bashkëpunim me UK Foreign, Commonëealth and Development Office të Mbretërisë së Bashkuar (FCDO), me mbështetjen e Universitetit të Lubjanës dhe Akademisë Sllovene të Shkencave dhe Arteve.

Kjo konferencë treditore reflektoi mbi sfidat në rritje me të cilat përballet komuniteti shkencor në të gjitha vendet e Procesit të Berlinit, si dhe mbi pritshmëritë e

larta që i adresohen shkencës në shoqëri. Pavarësisht nga këto sfida, shkenca vazhdon të dëshmojë rolin e saj të pazëvendësueshëm në zhvillim, stabilitet dhe përparim.

Tematikat kryesore të trajtuara në punimet e konferencës ishin:

- Mbrojtja e vlerave dhe parimeve të lirisë akademike dhe autonomisë institucionale, përfshirë rolin e tyre si hapësira të sigurta për demokracinë dhe mbrojtëse të sundimit të ligjit dhe barazisë;
- Kontributi i shkencës në konkurrueshmëri, ekonominë e dijes dhe sigurinë;
- Reformat kyçe për përshpejtimin e përafrimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor me standardet e BE-së, me vëmendje të veçantë ndaj pritshmërive të brezit të ri.

Në përfundim të konferencës u hartua një Deklaratë e Përbashkët me rekomandime konkrete për Samitin e 11-të të Ballkanit Perëndimor të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive, i cili do të mbahet më 22 tetor 2025 në Londër.

https://www.berlinprocess.de/#events

Akad. Anila Hoda mori pjesë në Asamblenë e 93-të të Union Académique Internationale (UAI), zhvilluar në Mainz të Gjermanisë

Akad. Anila Hoda, sekretare shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përfaqësoi ASHSH-në në Asamblenë e 93-të të UAI-t, që u mbajt në datat 13-15 tetor 2025 në Akademinë e Shkencave dhe të Letërsisë në Mainz, Gjermani.

Në mbledhjen e asamblesë morën pjesë përfaqësues të mbi 60 vendeve anëtare.

Në fjalët hapëse u theksua nevoja për përditësimin e strukturave organizative, rritjen e transparencës në menaxhimin e projekteve dhe përfshirjen e brezit më të ri të kërkuesve në iniciativat ndërakademike.

Pjesëmarrja në këtë ngjarje të nivelit të lartë ndërkombëtar të bashkëpunimit shkencor në fushat e shkencave humane dhe shoqërore kishte për qëllim forcimin e pranisë dhe rolit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në rrjetin ndërkombëtar të akademive anëtare të UAI-së, krijimin dhe zhvillimin e kontakteve të reja të bashkëpunimit me akademitë partnere europiane, si dhe njohjen nga afër me projekte ekzistuese dhe në zhvillim të kësaj organizate ndërkombëtare.

UAI

UNION ACADÉMIQUE INTERNATIONALE

Gjithashtu, pjesëmarrja synoi forcimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në përmirësimin e shkëmbimit të njohurive dhe përvojave akademike, si dhe në zgjerimin e perspektivave për integrim të plotë në nismat dhe programet kërkimore të UAI-së, duke mundësuar kontaktet e drejtpërdrejta me institucionet homologe dhe takimet për bashkëpunime të reja.

Një objektiv i rëndësishëm ishte dhe njohja me praktikat bashkëkohore për digjitalizimin e trashëgimisë kulturore dhe me sistemet bashkëkohore të dokumentimit dhe qasjes shkencore, me qëllim përgatitjen e projekteve të përbashkëta ndërakademike në kuadër të hapësirë europiane të kërkimit.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë pranohet anëtare nderi e Komunitetit Ndërkombëtar të Akademive – Koinon

Bordi drejtues i Komunitetit Ndërkombëtar të Akademive (Koinon) miratoi unanimisht aplikimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për t'u bërë anëtare nderi e saj. Në letrën zyrtare të prof. Christos Zerefos, Sekretar i Përgjithshëm i Akademisë së Athinës dhe President i Bordit të Drejtorëve të KOINON-it drejtuar Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, vlerësohet aplikimi i suksesshëm dhe pranimi i ASHSH-së në Koinon. Në letrën e tij shprehet besimi për bashkëpunimin mes institucioneve në vitet në vijim.

International Community (Koinon) of Academies (Komuniteti Ndërkombëtar i Akademive) është një organizatë ndërkombëtare që bashkon akademi shkencash nga vende të ndryshme, me qëllim që të nxitet bashkëpunimi akademik dhe shkencor.

www.akad.gov.al

Akad. Arben Merkoçi zgjidhet anëtar i Komitetit të Përhershëm për Politikat Shkencore të ALLEA-s (All European Academies)

Me krenari njoftojmë përzgjedhjen e akademikut Arben Merkoçi, përfaqësues i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si anëtar i Komitetit të Përhershëm për Politikat Shkencore të ALLEA-s (All European Academies), një nga strukturat më të rëndësishme të bashkëpunimit akademik në nivel evropian.

Ky komitet luan një rol kyç në hartimin, analizimin dhe promovimin e politikave shkencore evropiane, duke synuar forcimin e ndikimit të shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, inovacionin dhe politikat publike në hapësirën europiane të kërkimit.

Përzgjedhja e akademikut Arben Merkoçit vijoi pas propozimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Anëtarësimi në këtë strukturë të lartë përfaqëson një vlerësim të kontributit të tij shkencor ndërkombëtar, si dhe një arritje të rëndësishme për Akademinë e cila vazhdon të zgjerojë praninë dhe rolin e saj në rrjetet akademike europiane.

https://allea.org/publications/
https://www.eurasc.eu/members/arben-merkoci/member/
www.akad.gov.al

Akademik Nazim Gruda vlerësohet me diplomën "Shkencëtar i shquar" nga Akademia Kineze e Shkencave

Akademiku shqiptar prof. dr. Nazim S. Gruda u nderua nga Akademia Kineze e Shkencave (CAS) me diplomën "Shkencëtar i shquar" (Distinguished Scientist Aëard), një nga vlerësimet më prestigjioze që jepet nga ky institucion për kontributin e shquar në kërkimin shkencor ndërkombëtar.

Ceremonia e dorëzimit të diplomës u mbajt sot, më 21 tetor 2025, në ambientet e Institutit të Ruajtjes së Tokës dhe Ujit (Institute of Soil and Ëater Conservation), CAS.

Drejtori i Institutit, prof. dr. Renfang Shen, në prani të anëtarëve të Akademisë, studiuesve dhe përfaqësuesve të institucioneve kërkimore kineze mbajti fjalën e mirëseardhjes dhe i dorëzoi diplomën akad. Grudës.

Ai tha se prof. dr. Gruda është një shkencëtar ndërkombëtarisht i njohur në fushën e hortikulturës së qëndrueshme, bujqësisë inteligjente ndaj klimës, sistemeve të kultivimit pa tokë dhe cilësisë së produkteve hortikulture. Me mbi 40 vite përvojë shkencore, ai ka kontribuar në mënyrë të jashtëzakonshme në zhvillimin e metodave efikase të prodhimit, strategjive të përshtatjes ndaj klimës dhe rritjes së cilësisë ushqimore në nivel global. Ai ka mbi 400 publikime shkencore dhe teknike, përfshirë 36

libra dhe kapituj librash, ndërsa rreth 200 punime janë të indeksuara në Scopus, të realizuara në bashkëpunim me studiues nga më shumë se 40 vende. Ai jo vetëm listohet për gjashtë vite me radhë në "Stanford Top Most Influential Scientists in the Ëorld", por në vitin 2025 është renditur ndër 100 shkencëtarët më të cituar në botë në fushën e biologjisë së bimëve."

Pas dorëzimit të diplomës, akad. Gruda mbajti fjalën e tij të falënderimit. Ai u shpreh se ndihet thellësisht i nderuar. Në fakt, diplomimi ishte planifikuar për vitin 2020, por për shkak të pandemisë nuk u bë e mundur. "Ndihem i prekur që këtë vlerësim e ka marrë për herë të dytë nga Akademia Kineze e Shkencave – një institucion me prestigj të jashtëzakonshëm ndërkombëtar. Jam gjithmonë i mahnitur nga përparimi i jashtëzakonshëm i shkencës kineze, e cila po udhëheq zhvillimin e qëndrueshëm të vendit."

Akad. Gruda shtoi se "ky vlerësim është një nxitje për të forcuar bashkëpunimin mes Akademisë Kineze të Shkencave dhe Universitetit të Bonit (Gjermani), ku ai vepron si profesor, si dhe për të zgjeruar marrëdhëniet mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë Kineze të Shkencave."

Pas ceremonisë, akad. Gruda mbajti kumtesën e tij të parë shkencore me temë:

"Climate-Smart Agriculture and Sustainable Intensification – Vegetable Production" (Bujqësi e mençur ndaj klimës dhe intensifikim i qëndrueshëm – Prodhimi i perimeve", ku trajtoi ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe faktorëve para-korrjes në cilësinë e prodhimeve në serra.

Në vijim të qëndrimit të tij dyjavor në Kinë, akad. Gruda do të zhvillojë edhe një sërë aktivitetesh akademike, përfshirë kumtesa edhe në Institutin e Ruajtjes së Tokës dhe Ujit) në Xi'an, si dhe vizita kërkimore në serrat e platformat eksperimentale në Yangling (Provinca Shanxi) dhe Nanjing.

Ky vlerësim dëshmon kontributin e shkencës shqiptare në zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme dhe inovacionit shkencor global.

www.akad.gov.al

Çmimet Nobel

Joel Mokyr, Philippe Aghion dhe Peter Hoëitt vlerësohen me çmimin "Nobel" 2025 në ekonomi



Fituesit e çmimit "Nobel" në ekonomi' për vitin 2025 janë shpallur Joel Mokyr, Philippe Aghion dhe Peter Hoëitt për kërkimet e tyre mbi "rritjen ekonomike të nxitur nga inovacioni", deklaroi Akademia Mbretërore Suedeze e Shkencave.

"Gjatë dy shekujve të fundit, për herë të parë në histori, bota ka dëshmuar rritje të qëndrueshme ekonomike. Kjo ka nxjerrë një numër të madh njerëzish nga varfëria dhe ka hedhur themelet për prosperitetin tonë. Fituesit e Nobelit të këtij viti në ekonomi, Joel Mokyr, Philippe Aghion dhe Peter Hoëitt, shpjegojnë se si inovacioni siguron shtysën për përparim të mëtejshëm", shkruhet në deklaratën e Komitetit të Nobelit.

Mokyr dhe Hoëitt jetojnë e punojnë në Shtetet e Bashkuara, ndërsa Aghion operon në lidhje me institucionet në Francë dhe në Britaninë e Madhe.

www.akad.gov.al

Maria Corina Machado fiton çmimin Nobel për Paqen 2025

Liderja e opozitës në Venezuelë, Maria Corina Machado, është vlerësuar nga Komiteti i Nobelit për rolin e jashtëzakonshëm në mbrojtjen e të drejtave demokratike në një nga vendet më të goditura nga autoritarizmi në Amerikën Latine.

Sipas deklaratës zyrtare të Komitetit të Nobelit: "Machado nderohet për punën e saj të palodhur në promovimin e të drejtave demokratike për popullin e Venezuelës dhe për luftën e saj për një tranzicion të drejtë dhe paqësor nga diktatura drejt demokracisë."

Znj. Machado është detyruar të jetojë e fshehur brenda territorit të Venezuelës, pas zgjedhjeve të vitit të kaluar, që u konsideruan gjerësisht të manipuluara dhe të fituara padrejtësisht nga presidenti aktual, Nicolás Maduro.

Pavarësisht kërcënimeve serioze për jetën, ajo nuk e braktisi vendin e saj; një vendim që ka frymëzuar miliona njerëz. Ajo ka bashkuar opozitën dhe nuk është lëkundur kurrë në rezistencën ndaj militarizimit të shoqërisë venezueliane.

Gjithmonë ka qenë e bindur në misionin e saj për një tranzicion paqësor drejt demokracisë.

www.akad.gov.al

Çmimi "Nobel" 2025 në letërsi iu dha shkrimtarit hungarez László Krasznahorkai

Akademia e Shkencave e Suedisë vlerësoi me çmimin "Nobel" për letërsi shkrimtarin hungarez László Krasznahorkai për veprën e tij bindëse dhe vizionare, e cila në kulmin e terrorit apokaliptik riafirmoi fuqinë e artit.



László Krasznahorkai është një shkrimtar i madh epik në traditën e Europës Qendrore, e cila shtrihet nga Kafka te Thomas Bernhardi dhe karakterizohet nga absurdi e grotesku, thuhet ndër të tjera në motivacionin e Nobelit.

Për më shumë, shiko linkun:

https://www.nobelprize.org/.../lit.../2025/bio-bibliography/

www.akad.gov.al

Jepet çmimi "Nobel" 2025 në fizikë për tre shkencëtarët: John Clarke, Michel H. Devoret dhe John M. Martinis

Çmimi "Nobel" në Fizikë 2025 iu dha John Clarke, Michel H. Devoret dhe John M. Martinis "për zbulimin e tunelimit makroskopik mekanik kuantik dhe kuantizimit të energjisë në një qark elektrik".



Komiteti Nobelit i vlerësoi fituesit për faktin se kanë zbuluar vetitë e çuditshme të botës kuantike, që me një qark elektronik të ndërtuar nga superpërçues mund të përçojnë një rrymë pa rezistencë elektrike.

Ata eksploruan fenomenin duke kaluar një rrymë përmes tij. Grimcat e ngarkuara që lëviznin përmes superpërçuesit përbënin një sistem që sillej sikur të ishte një grimcë e vetme që mbushte të gjithë qarkun, që do të thotë se thith ose lëshon vetëm sasi specifike energjie.

Ky është çmimi i dytë "Nobel" për vitin 2025 që shpallet këtë javë.

Për më shumë, lexo linkun:

https://www.nobelprize.org/prizes/physics/2025/summary/

Jepet çmimi "Nobel" 2025 në fiziologji ose mjekësi për tre shkencëtarë: Mary E. Brunkoë, Fred Ramsdell dhe Shimon Sakaguchi

Asambleja e çmimit "Nobel" në Institutin Karolinska i ka vlerësuar fituesit Mary E. Brunkoë, Fred Ramsdell dhe Shimon Sakaguchi për zbulimet e reja në lidhje me tolerancën imunitare periferike që parandalon sistemin imunitar të dëmtojë trupin.



Laureatët kanë zbuluar se si mbahet në kontroll sistemi imunitar, duke identifikuar rojat e sigurisë së sistemit imunitar, qelizat T rregullatore, të cilat parandalojnë qelizat imunitare të sulmojnë trupin tonë.

Zbulimet e tyre përqendrohen në fushën e tolerancës periferike, duke nxitur zhvillimin e trajtimeve mjekësore për kancerin dhe sëmundjet autoimune. Këto zbulime mund të çojnë në transplantime më të suksesshme. Disa nga këto trajtime tani po u nënshtrohen provave klinike.

Për më shumë, lexo linkun:

https://www.nobelprize.org/all-nobel-prizes-2025/

Shpallet çmimi Nobel 2024 në kimi për tre shkencëtarë: gjysma iu dha David Baker-it dhe gjysma tjetër iu dha shkencëtarëve Demis Hassabis dhe John M. Jumper

Çmimi Nobel 2024 në kimi u nda në datën 9 tetor 2024 mes tre shkencëtarëve që kanë parashikuar dhe madje dizajnuar strukturën e proteinave, si blloqet ndërtuese të jetës që formojnë kockat, lëkurën, flokët dhe indet.

Gjysma e çmimit iu dha David Baker-it për kontributin e tij novator në hartimin e proteinave llogaritëse, një metodë që lejon shkencëtarët të krijojnë proteina me funksione të përshtatura. Gjysma tjetër iu dha shkencëtarëve Demis Hassabis dhe John M. Jumper për parashikimin e strukturës së proteinave.

David Baker punon në Universitetin e Uashingtonit në Seattle, ndërsa Demis Hassabis dhe John Jumper punojnë në Google DeepMind, një laborator kërkimor i inteligjencës artificiale britaniko-amerikane me bazë në Londër.

Hassabis dhe Jumper krijuan një model të inteligjencës artificiale që ka qenë në gjendje të parashikojë strukturën e pothuajse të gjitha 200 milionë proteinave që studiuesit kanë identifikuar.

Për më shumë lexo linkun:

https://www.nobelprize.org/prizes/chemistry/2025/press-release/

In memoriam

Akademia e Shkencave kujton me nderim shkrimtarin akademik Dritëro Agolli në 94-vjetorin e lindjes



Dritëro Agolli, poet, prozator, publicist dhe politikan, solli përmes veprave të tij një frymë të re në letërsinë shqipe, duke prekur me ndjeshmëri jetën e përditshme, tokën, fshatarin dhe shpirtin e popullit.

Për vite me radhë ai qëndroi në krye të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, post të cilin e mori në vitin 1973. Ai pati një ndikim të fuqishëm në zhvillimin kulturor e artistik të vendit.

Ai shkroi poezi, poema, tregime, novela, romane, drame dhe skenarë filmash.

Kolosi i letërsisë shqiptare u nda nga jeta në moshën 85-vjeçare, më 3 shkurt 2017.

Për më shumë, lexo linkun:

https://akad.gov.al/akademik-dritero-agolli/

www.akad.gov.al

Mesazh ngushëllimi

Komisioni i Fizikës dhe Kimisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, shpreh dhimbjen e thellë për ndarjen nga jeta të prof. dr. Adelaida Andonit, pedagoge dhe studiuese me kontribute të çmuara në fushën e kimisë.

Ajo do të kujtohet për përkushtimin, integritetin akademik, mirësinë e saj, dhe rolin e saj frymëzues në formimin e brezave të studentëve dhe në pasurimin e kërkimit shkencor.

Ngushëllimet më të sinqerta familjes, kolegëve dhe miqve të saj.

U prehtë në paqe!

www.akad.gov.al